

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes



Mbrojtja

Viti i 90-të i botimit
Maj 2022/ Nr. 5

5 MAJ

DITA E DËSHMOREVE TË KOMBIT SHQIPTAR

**Ministri i Mbrojtjes Peleshi:
Mirënjohje për bijtë dhe
bijat që dhanë jetën për
liri dhe e rreshtuan vendin në
krahun e drejtë të historisë**



Përmbajtja

Numri 5

MBËSHTETJA

- 6** Rama u akordon 11 fëmijëve të parë statusin "Fëmijë në përkujdesje të Republikës"

PROJEKTI

- 11** "Defender Europe 2021", ndihma për qendrën shëndetësore të Shëngjergjit pas stërvitjes së përbashkët

ARSIMIMI

- 32** Studentët e FA-së vizitojnë "West Point"

SFIDAT

- 36** Fuqizimi i avantazhit teknologjik të NATO-s

DOSSIER

- 44** Lidhja e Kombeve dhe Shqipëria në rrugëtimin shekullor të saj

STAFI

ANJEZA MUSOLLARI
Shefe e Sektorit të Botimeve
& Kryeredaktor

Gazetarë:
Mimoza GOLIKJA

Graphic Designer:
Afërdita HYSAJ

Redaktore/ korrektore:
Suela HODA



4 HOMAZHET

5 Maji, Dita e Dëshmorëve të Kombit Shqiptar

5 Maji, Dita e Dëshmorëve të Kombit që kanë dhënë jetën e tyre për liri, demokraci, të drejtat e njeriut dhe dinjitetin e çdo shqiptari. Dita e...



8 KONFERENCA

Peleshi: Do të mbështesim pa kushte popullin ukrainas

Ministri i Mbrojtjes z. Niko Peleshi i shoqëruar nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Bajram Begaj, morën pjesë në konferencën...



7 BASHKËPUNIMI

Ministria e Mbrojtjes, dhjetë milionë dollarë për Emergjencat Civile

Njësitë e vetëqeverisjes vendore do të kenë më shumë burime financiare për të përballuar emergjencat civile në territorin e tyre. Në bazë të ligjit 45/2019, "Për Mbrojtjen...



24 Intervistë me gjeneral brigade Astrit Jaupin

Udhëtimi 71-vjeçar i kaltërsive Shqiptare

Gjeneral brigade Astrit Jaupi (ish-komandant i Forcës Ajrore) me një eksperiencë të gjatë si aviator dhe drejtues force, në krenmtimin e 71-vjetorit të krijimit...

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

Mbrojtja



Botues:

Qendra e Kulturës, Medias,
Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut
Drejtoria e Kulturës, Medias dhe
Botimeve të Mbrojtjes

Adresa:

Rruga e Dibrës/ Garnizoni "Skënderbej"

REVISTA MBROJTJA

Organ Qendror
i Ministrisë së Mbrojtjes
Viti i 90-të i botimit
Nr. 5/ 2022

© Ministria e Mbrojtjes

Materialet e publikuara në këtë
revistë nuk mund të riprodhohen
elektronikisht apo fizikisht e të
përdoren për qëllime përfitimi, pa
marrë autorizim nga botuesit e saj.

**Revista mund të gjendet në formatin
elektronik (pdf) në adresën:**

[http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/
publikime/revista-mbrojtja](http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikime/revista-mbrojtja)



5 Maji, Dita e Dëshmorëve të Kombit Shqiptar

Ministri Peleshi: Mirënjohje për bijtë dhe bijat që dhanë jetën për liri dhe e rreshtuan vendin në krahun e drejtë të historisë



5 Maji, Dita e Dëshmorëve të Kombit që kanë dhënë jetën e tyre për liri, demokraci, të drejtat e njeriut dhe dinjitetin e çdo shqiptari.

Dita e Dëshmorëve e ka origjinën më 5 maj 1942, kur u vra Qemal Stafa, i cili me veprimtarinë e tij u kthye në simbol të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.

Në nderim të kujtimit të të rënëve për lirinë e vendit, çdo vit në Varrezat e Dëshmorëve kryhen homazhe nga krerët më të lartë të shtetit shqiptar. I pranishëm në këtë ceremoni ishte dhe ministri i mbrojtjes z. Niko Peleshi, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së gjeneralmajor Bajram Begaj, komandanti i Forcave Ajrore gjeneral brigade Ylli Pulaj, të cilët bënë homazhe pranë varrezave të Dëshmorëve të Atdheut dhe 43 ushtarakëve të Forcave Ajrore, të rënë në krye të detyrës.

Dita e Dëshmorëve e ka origjinën më 5 maj 1942, kur u vra Qemal Stafa, i cili me veprimtarinë e tij u kthye në simbol të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.



NËNA SHQIPËRI nuk ju harron kurrë

Lavdi Dëshmorëve të Aviacionit Shqiptar

"Dëshmorët janë lapidarë e memorialë, pasuri e çmuar kombëtare, trashëgimia më sublime e ndërgjegjes shqiptare, janë vlerat, virtytet, nderimi dhe mirënjohja e idealit të ndërgjegjes së një kombi vital të lashtë sa toka! Dëshmorët e mbrojtjes së hapësirës ajrore shqiptare janë pjesë e historisë dhe lavdisë shqiptare. Ata dhanë jetën e tyre në emër të një misioni të madh, dhanë gjithçka që patën prandaj meritojnë nderim. Ata janë përjetësisht të stacionin e përjetësisë qiellore në roje të qiellit dhe idealit shqiptar. Tek ky stacion qiellor përjetësie është e kaluara që ndriçon të ardhmen. Ata kanë qenë dhe kanë ngelur besnikërisht në altarin e përjetësisë të palëkundur në idealin e tyre."

Dëshmorë të Atdheut

Ibush Vokshi, Sokrat Bashaj, Qemal Mërtiri, Fuat Sulaj, Islam Xhani, Vasil Trasha, Jovan Kaçori, Hektor Lako, Niko Hoxha, Stilian Tanku, Muharrem Hida, Refit Jazo, Kaso Petroshti, Shyqyri Balla, Azbi Serani, Islam Mani, Bego Hoxha, Dhimitër Robo, Veiz Kovaçi, Sefedin Tomçini, Vasil Noni, Shpëtim Sula, Sabri Toci, Armando Gjoka, Luto Sadikaj, Ndue Logu, Haki Skuqi, Jorgji Fane,

Agron Galanxhi, Vangjel Postoli, Pandeli Zhupa, Tafil Agai, Enver Haka, Fluturim Molla, Eduart Kostëdhima, Idriz Hoxha, Jani Tarifa, Vangjel Çondi, Demush Heba, Qemal Koni, Florian Delia, Donald Hoxha.



Mbështetja

Rama u akordon 11 fëmijëve të parë statusin “Fëmijë në përkujdesje të Republikës”

“**A**sgjë nuk e zëvendëson më figurën e prindit por dhënia e kujdesit financiar në shumicën e barabartë të pagës së prindit deri në moshën e përfundimit të studimeve të larta është një mbështetje kuptimplotë pas një periudhe të gjatë. Për fëmijët, statusi i veçantë parashikon edhe marrjen e kujdesit shëndetësor falas edhe në strukturat më të specializuara jashtë vendit.

I gjithë procesi i shkollimit me bursa të plota dhe përjashtim të plotë nga tarifat. Për të ardhur edhe te orientimi profesional dhe mbështetja shtetërore për punësimin e tyre. Ky status u takon të gjithë fëmijëve të dëshmorëve, mjekëve dhe infermierëve që humbën jetën në vijën e parë të luftës me armikun e padukshëm. Sot këtu janë 11 fëmijët e parë nën përkujdesjen e republikës dhe ndërkohë komisioni i posaçëm vijon me trajtimin e rasteve të tjera”, -deklaroi Rama.

Paketa e mbështetjes për fëmijët në përkujdesje të Republikës parashikon:

- 100 për qind të pagës së prindit për çdo fëmijë, kur në ngarkim të personit që ka humbur jetën, ka vetëm një fëmijë që gëzon statusin “Fëmijë në përkujdesje të Republikës”,
- 70 për qind për çdo fëmijë,



- kur në ngarkim të personit, që ka humbur jetën, ka dy fëmijë të mitur;
- 50 për qind për çdo fëmijë, kur në ngarkim të personit, që ka humbur jetën, ka tre fëmijë;
- 40 për qind për çdo fëmijë, kur në ngarkim të personit, që ka

humbur jetën, ka katër fëmijë;

- 30 për qind për çdo fëmijë, kur në ngarkim të personit, që ka humbur jetën, ka më shumë se katër fëmijë që gëzojnë statusin “Fëmijë në përkujdesje të Republikës”.

Bashkëpunimi

Ministria e Mbrojtjes, dhjetë milionë dollarë për Emergjencat Civile

Ky është vetëm fondi që u akordohet bashkive nga Buxheti i Shtetit, pasi sipas ligjit 45/2019 njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të planifikojnë fonde të tjera shtesë nga të ardhurat e veta vendore, nga fondet që u vijnë drejtpërdrejt nga ndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare, huamarrja vendore, donacionet etj.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore do të kenë më shumë burime financiare për të përballuar emergjencat civile në territorin e tyre.

Në bazë të ligjit 45/2019, "Për Mbrojtjen Civile" dhe buxhetit të vitit 2022, Ministria e Mbrojtjes u ka akorduar bashkive një fond total prej 10 milionë dollarë. Ky fond u është shpërndarë të 61 bashkive të Republikës së Shqipërisë, bazuar në peshën specifike që zë buxheti i çdo bashkie ndaj

totalit të buxhetit të të gjitha bashkive. Fondi ndihmon bashkitë në përmbushjen e detyrimeve të tyre në kuadër të reduktimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile. Megjithatë, ky është vetëm fondi që u akordohet bashkive nga Buxheti i Shtetit, pasi sipas ligjit 45/2019 njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të planifikojnë fonde të tjera shtesë nga të ardhurat e veta vendore, nga fondet që u vijnë drejtpërdrejt nga ndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare, huamarrja vendore, donacionet etj.





SHBA, konferencë për situatën në Ukrainë

Peleshi: Do të mbështesim pa kushte popullin ukrainas

Ministri i Mbrojtjes z. Niko Peleshi i shoqëruar nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FAsë, gjeneralmajor Bajram Begaj, morën pjesë në konferencën për Ukrainën, të thirrur nga sekretari

i Mbrojtjes së SHBA-ve, Lloyd Austin, e cila u mbajt në bazën ajrore në Ramstein të Gjermanisë.

Në këtë konferencë, SHBA-të kishin ftuar të merrnin pjesë

ministrat e Mbrojtjes dhe përfaqësues nga 40 vende të ndryshme, ku u diskutua mbi situatën në Ukrainë, nevojat që ky vend ka për asistencë në planin aktual dhe atë afatgjatë, dinamikat e



dhënë për Ukrainën. Ai u ndal në tre aspekte kryesore në të cilat konsiston kjo mbështetje, në rolin e Shqipërisë në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, si bashkëpenëmbajtëse me SHBA-të, në situatën dhe mbështetjen humanitare për pritjen dhe akomodimin e refugjatëve ukrainas, si dhe në suportin në terma praktikë që vendi ynë ka dhënë.

Në fund të fjalës së tij, zoti Peleshi siguroi pjesëmarrësit në këtë takim se, Shqipëria do të vijojë mbështetjen pa kushte për qeverinë dhe popullin ukrainas edhe në termat afatgjatë, përveç mbështetjes aktuale që jemi duke dhënë.



Shqipëria do të vijojë mbështetjen pa kushte për qeverinë dhe popullin ukrainas edhe në termat afatgjatë, përveç mbështetjes aktuale që jemi duke dhënë

luftimeve në Ukrainë, vlerësimi i kapaciteteve të tyre luftarake, mundësitë e kontributit për përmirësimin e këtyre kapaciteteve, si dhe rritjen e aftësive mbrojtëse të këtij vendi, në të ardhmen.

Në fjalën e tij, ministri Peleshi falënderoi organizatorët e këtij evenimenti mjaft të rëndësishëm, veçanërisht sekretarin Austin, si dhe bëri një rezymë të mbështetjes që vendi ynë ka



U përrua Qendra Kombëtare Operacionale e Emergjencave Civile e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile. Ajo u bë e mundur falë grantit prej 1 milion eurosh, të vënë në dispozicion nga Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim.

Në ceremoninë e zhvilluar me këtë rast, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi e cilësoi këtë një investim shumë të rëndësishëm, i cili sjell një tjetër standard të lartë në shërbimin dhe menaxhimin e



Përrua Qendra Kombëtare Operacionale e Emergjencave Civile



Ministri Peleshi: Hapi i parë drejt ngritjes së një sistemi modern të Mbrojtjes Civile

sistemit të Mbrojtjes Civile në Shqipëri. Ministri Peleshi shprehu mirënjohjen e popullit shqiptar për angazhimin e Italisë në situata emergjente dhe kritike si ajo e tërmetit të vitit 2019, apo edhe përgjatë pandemisë COVID - 19: "Ambicia jonë është e madhe, së bashku me bashkinë e Tiranës ne jemi përkrah në këtë hap të parë që do të shoqërohet më tej, nga një program shumë më i madh prej 30 milionë eurosh, në kuadër të një ndihme prej 95 milionë eurosh,

Qendra Kombëtare e Operacionale e Emergjencave Civile ka kapacitet për 12 operatorë nga forca të ndryshme që janë të përfshira në operacione në terren, sipas ministrive të ndryshme, në varësi të ndodhjes dhe llojit të emergjencës.



dhe këtu Italia ka rolin e liderit. Pra, kemi bërë hapin e parë për të shkuar drejt një sistemi vërtetë modern, bashkëkohor të mbrojtjes civile për t'iu përgjigjur në kohë, krah për krah me bashkitë që janë në frontin e parë me emergjencat civile, çdo lloj fatkeqësie natyrore e për të mbrojtur qytetarët tanë”, - u shpreh gjatë fjalës së tij, ministri Peleshi. Ministri i Mbrojtjes sqaroi se: “në këtë qendër do të ketë vendin e vet çdo institucion përgjegjës për Mbrojtjen Civile dhe sapo të merret thirrja për një rast fatkeqësie, do të jetë këtu për të bashkëpunuar edhe fizikisht”.

Z. Peleshi njoftoi se falë projektit tjetër do të nisin investimet edhe në bashkitë e vendit, për të bërë të mundur një reagim të menjëhershëm dhe profesional në raste zjarresh apo përmbytjesh.

Të pranishëm në këtë ceremoni ishin edhe kryetari i Dhomës Italiane, Roberto Fico, kryetari i Bashkisë, Erion Veliaj, ambasadori i Italisë në Shqipëri, Fabrizio Buci, drejtori i Agjencisë Italiane të Bashkëpunimit për Zhvillim, Luca Maestripieri dhe drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile Haki Çako.

Presidenti i Dhomës Italiane Roberto Fico, vuri në dukje ra-

“Në këtë qendër do të ketë vendin e vet çdo institucion përgjegjës për Mbrojtjen Civile dhe sapo të merret thirrja për një rast fatkeqësie, do të jetë këtu për të bashkëpunuar edhe fizikisht”.

portet mjaft të mira të bashkëpunimit mes dy vendeve: “Edhe Italia është një vend i goditur nga tërmetet. Eksperienca jonë e bashkëpunimit është e shkëlqyer. Ky investim mendoj se do të shërbejë jo vetëm për të shpëtuar jetë, por edhe për të parandaluar fatkeqësi, si ajo që ndodhi në Shqipëri në 2019 dhe në Itali në disa raste. Ky është fillimi i një udhëtimi që ne do të bëjmë së bashku, i cili do të ketë disa zhvillime me synim arritjen e standardeve europiane në fushën e Mbrojtjes Civile”. Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj tha se: “Ne duhet të jemi përditë të përgatitur sikur çdo ditë do ndodhë një gjë që ndodh në 100 vjet. Ky është definicioni i një kombi serioz”.

Drejtori i Përgjithshëm Agjencisë

Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Haki Çako shpjegoi se Qendra Kombëtare e Operacionale e Emergjencave Civile ka kapacitet për 12 operatorë nga forca të ndryshme që janë të përfshira në operacione në terren, sipas ministrive të ndryshme, në varësi të ndodhjes dhe llojit të emergjencës. Sipas tij: “Ky inaugurim duhet të jetë fillimi i një rruge zhvillimi progresiv që do ta sjellë Shqipërinë në një shkallë të mjaftueshme autonomie në menaxhimin e emergjencave”. Qendra Kombëtare Operacionale e Emergjencave Civile, e vendosur në një mjedis të vënë në dispozicion nga bashkia e Tiranës do të përmirësojë koordinimin dhe komunikimin e strukturave të Sistemit të Mbrojtjes Civile në rastet e Emergjencave Civile.

Ambasadorja e SHBA-së

Yuri Kim, vizitë në Zall-Herr

Me rastin e instalimit të ekipit të Brigadës së Asistencës së Forcave të Sigurisë (SFAB) së SHBA-së në Zall-Herr, që do të mbështesin personelin e Grup-Batalionit të

Këmbësonisë së Lehtë, Ambasadorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, znj. Yuri Kim vizitoi këtë regjiment, ku u prit nga komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji. Gjatë kësaj vizite u ndoqën nga afër sekuenca të trajnimeve stërvitore nga efektivat e batalionit të Dytë të Këmbësonisë, trajnime të cilat do të zhvillohen mes dy ushtrive tona në vazhdimësi.



“Unë vrapoj për një Hero! Heroi im është një grua!”

“NATO Run, Tirana 2022”, solli sërish edhe këtë vit, vrapimin sensibilizues me kauzën “Unë vrapoj për një Hero! Heroi im është një grua!”. Kjo kauzë simbolizon rolin e vlerave transatlantike dhe kontributit të të gjithë heronjve tanë. Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura të RSH iu bashkuan edhe sot kësaj nisme duke kontribuar me shumë pjesëmarrës dhe tre fitues.



PROJEKTI

“Defender Europe 2021”, ndihma për qendrën shëndetësore të Shëngjergjit pas stërvitjes së përbashkët

Qendra Shëndetësore e Shëngjergjit është pajisur me aparaturë e medikamente shtesë, falë ndihmës së projektit të ekipit të përbashkët shqiptaro-amerikan të Bashkëpunimit Civilo-Ushtarak. Ky donacion vjen pas një vlerësimi që iu bë situatës gjatë stërvitjes së përbashkët “Defender Europe 2021”. Në ceremoninë e dhurimit, zëvendësministria e Mbrojtjes, znj. Dallëndyshe Bici shprehu falënderimin për palën amerikane dhe Komandën Europiane, e cila financoi këtë donacion. “Kjo është një ndihmë e parë, por duke parë më tej nevojat që ka ky komunitet besoj se në të ardhmen edhe me ndihmën e vyer të Ambasadës amerikane ne do të kemi më shumë për komunitetin tuaj”, - iu drejtua ajo banorëve të zonës dhe punonjësve. Nga ana e tij, zëvendës ambasadori amerikan Demian Smith tha se kjo ndihmë është një shenjë falënderimi për banorët e zonës dhe Shqipërinë, e cila



punoj krah SHBA-së për suksesin e stërvitjes “Defender Europe ‘21”. “Mbështetja juaj gjatë stërvitjes së përbashkët “Defender ‘21” ishte vendimtare për suksesin tonë të përbashkët. Kjo ngjarje historike i tregoi edhe një herë botës se Shqipëria është një aleatë e pakrahueshme në mikpritjen e miqësinë e saj. Puna jonë e përbashkët nuk ka përfunduar tek festojnë 100 vjet miqësi. “Defender ‘21” ishte vetëm fillimi i një rrugë të gjatë që kemi përpara. Shqipëria është ofruar edhe një herë për stërvitjen e ardhshme

ushtarake, për t’i treguar edhe një herë botës se nuk ka miqësi më të fortë”, - u shpreh zëvendës ambasadori Smith. Zëvendësministria e Shëndetësisë Mira Rakacolli, e pranishme në ceremoni, falënderoi SHBA-të për kontributin e dhënë edhe gjatë kohës së pandemisë, duke theksuar se për shëndetësinë gjithmonë ka nevojë për më shumë. Pajisjet dhe medikamentet shëndetësore të dhuruara do t’i shërbejnë edhe fshatrave përreth zonës së Shëngjergjit.

Ministri Peleshi: Në dy vite janë ndërtuar 25 ura, bashkëpunim me pushtetin vendor për përgjigje ndaj të gjitha kërkesave

Në prani të banorëve të zonës, ministri i Mbrojtjes z. Niko Peleshi inspektoi përfundimin e ndërtimit të urës "bailey" mbi lumin Dunavec në fshatin Voskop të Korçës. Kjo urë është 24 metra e gjatë dhe do t'u vijë në ndihmë dhjetëra banorëve të zonës.

I shoqëruar edhe nga drejtori i Agjencisë së Mbrojtjes Civile z. Haki Çako dhe kryetari i Bashkisë së Korçës z. Sotirag Filo, ministri Peleshi vuri në dukje faktin se prej kohësh Forcat e Armatosura, përmes edhe koordinimit të Agjencisë së Mbrojtjes Civile janë në mbështetje të komuniteteve në të gjithë vendin për t'u lehtësuar jetën, duke qenë në gatishmëri edhe në raste fatkeqësish natyrore përkrah pushtetit vendor. "Janë dhjetëra hektarë ferma që janë në krahun tjetër të lumit dhe banorëve u duhej të bënin kilometra të tëra për të aksesuar pronat e tyre. Me investime të tilla, si kjo urë në Voskop apo edhe 25 të tjera



që kemi ndërtuar në këto dy vitet e fundit në të gjithë Shqipërinë, janë mbi 20 mijë banorë të cilëve u është lehtësuar veprimtaria, jo vetëm në ekonominë e tyre bujqësore, por edhe shërbimet publike siç janë p.sh. shkollat, qendrat

shëndetësore, etj...", - u shpreh ministri Peleshi. Ministri i Mbrojtjes u shpreh se bashkëpunimi me pushtetin vendor do të vijoje në të gjithë vendin për t'u përgjigjur të gjitha kërkesave, që siç tha ai janë të shumta.

BASHKËPUNIMI

Fregata e Forcës Detare franceze "Aconit F-713", zhvilloi një vizitë portuale në portin e Durrësit

Fregata e Forcës Detare franceze "Aconit F-713", zhvilloi një vizitë portuale në Portin e Durrësit. Vizita kishte në fokus forcimin dhe bashkëpunimin midis Forcës Detare shqiptare dhe Forcës Detare franceze, duke rritur shkallën e ndërveprimit përmes trajnimeve në kuadrin e angazhimeve të përbashkëta në NATO. Komandanti i fregatës franceze "Aconit F-713", kapiten i rangut të dytë Jean-Bertrand Guyon u prit nga komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnan Agastra në një takim kortezie në Komandën e Forcës Detare. Gjatë kësaj vizite portuale, midis personelit të Forcës Detare dhe personelit të fregatës franceze,



në bordin e fregatës franceze "Aconit F-713" dhe anijes "Lisus" u zhvilluan disa stërvitje të përbashkëta sipas planit. Me rastin e vizitës së fregatës

franceze "Aconit F-713", shkëlqesia e saj znj. Elisabeth Barsacq, zhvilloi një pritje në bordin e fregatës franceze me pjesëmarrjen e autoriteteve të larta ushtarake dhe përfaqësues diplomatikë të akredituar në vendin tonë.

Gjithashtu ambasadorja e Republikës së Francës në Shqipëri, shkëlqesia e saj znj. Elisabeth Barsacq dhe komandanti i fregatës franceze "Aconit F-713", kapiten i rangut të dytë Jean-Bertrand Guyon zhvilluan takime në bashkinë dhe prefekturën e Durrësit.

Personeli i fregatës franceze zhvilloi gjithashtu edhe një vizitë kulturore në Muzeun Historik Kombëtar të Krujës.

“Turqia është dhe mbetet një partner strategjik”

Mirënjohje për ndihmën, asistencën, dhe arsimimin ushtarak të dhënë ndër vite për Forcat e Armatosura

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor, prof. asoc. Bajram Begaj, i shoqëruar nga komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Arben Kingji dhe përfaqësues të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, zhvilloi një vizitë zyrtare në Ankara, Turqi, me ftesë të homologut të tij, gjeneral Yaşar Güler. Gjatë vizitës në Ankara, gjeneralmajor Begaj, fillimisht vendosi kurorë në Memorialin Mauzole në nderim të themeluesit të Republikës së Turqisë, Mustafa Kemal Atatürk.

Më pas, gjeneralmajor Begaj u prit me nderimet më të larta ushtarake dhe zhvilloi një takim me shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura Turke, gjeneral Yaşar Güler. Në takimin me gjeneral Güler u nënvizua rëndësia e bashkëpunimit ushtarak dypalësh dhe aktivitetet e përbashkëta midis Forcave të Armatosura. “Bashkëpunimi në fushën e Mbrojtjes është intensiv dhe për Shqipërinë, Turqia është dhe mbetet një partner strategjik me marrëdhënie të shkëlqyera. Falënderimet më të përzemërta për shtetin turk për të gjithë ndihmën, asistencën dhe mbështetjen e dhënë ndër vite për edukimin dhe arsimimin ushtarak, mbështetjen e vazhdueshme mjekësore për



Forcat e Armatosura, por edhe ndihmën për tejkalimin e pasojave të tmerrshme të tërmetit që goditi Shqipërinë në vitin 2019 dhe më pas për përballimin e pasojave nga pandemia Covid-19”, - theksoi gjeneralmajor Begaj në fjalën e tij. Gjeneral Güler nga ana e tij e falënderoi gjeneralmajor Begaj për vizitën si dhe vlerësoi maksimalisht bashkëpunimin ushtarak dypalësh, duke siguruar se Forcat e Armatosura turke do të vazhdojnë

mbështetjen, duke rritur nivelin e asistencës në fushën e trajnimit dhe arsimimit ushtarak, stërvitjes si dhe modernizimit të FARSH. Vizita e delegacionit vijoi më tej në Komandën e Forcës Tokësore dhe atë të Forcave Speciale turke, ku u diskutua për bashkëpunimin ndërmjet Forcave tona të Armatosura, në kuadër të stërvitjeve, trajnimeve dhe aktiviteteve me NATO-n, po ashtu edhe ato të përbashkëta midis dy vendeve.

Gjeneralmajor Begaj pret komandantin e Forcave të Mbështetjes Logjistike të FA të Austrisë, gjeneralmajor Andreas Pernsteiner

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj priti në një takim kortezie, komandantin e Forcave të Mbështetjes Logjistike të FA të Austrisë, gjeneralmajor Andreas Pernsteiner, si dhe komandantin e Shkollës Logjistike gjeneral brigade Stefan Lampl.

Në fjalën e tij, gjeneralmajor Begaj vlerësoi rolin dhe angazhimin e Forcave të Armatosura të Austrisë në bashkëpunimin dypalësh në fushën e mbrojtjes, sikundër vlerësoi shumë të rëndësishme dhe në interes për FARSH në të ardhmen, asistencën e Shkollës Logjistike austriake për kurse dhe trajnime profesionale të ndryshme në specialitetet transport dhe furnizim, kërkim-shpëtim, EOD dhe siguri fizike të menaxhimit të stoqeve. "Gjithashtu, në kuadër të ristrukturimit të emergjencave civile ndihma ushtarake për këto njësi do të ishte mjaft e rëndësishme", -u shpreh ndër të tjera gjatë takimit gjeneralmajor Begaj. Nga ana e tij, gjeneralmajor Pernsteiner, pasi falënderoi gjeneralmajor Begaj për pritjen e ngrohtë, vlerësoi rolin e Shqipërisë për kontributin e saj në Aleancë dhe në sigurinë rajonale, si dhe shprehu mbështetjen e tij për rritjen më



tej të bashkëpunimin dypalësh në fushën e mbrojtjes midis dy vendeve tona.

Vizita e komandantit të Forcave të Mbështetjes Logjistike të FA të

Austrisë në Shqipëri përfshin takim pune në Komandën Mbështetëse dhe në Qendrën Stërvitore të KM, ku do të njihet më nga afër me kapacitetet dhe aktivitetet e tyre.



Në Qendrën Stërvitore të Komandës Mbështetëse zhvillohet ceremonia e përfundimit të Kursit EOD

“Kursi EOD Niveli II, si dhe ai bazë i sigurisë fizike dhe menaxhimit të municioneve janë kurse funksionalë, nëpërmjet të cilëve realizohet formimi profesional i ushtarakëve të FA-së, duke i përgatitur pjesëmarrësit në rolin e Instruktorit EOD si dhe angazhimin dhe përgatitjen në pikëpamje të menaxhimit e sigurisë së municioneve.

Në mjediset e Qendrës Stërvitore të Komandës Mbështetëse u zhvillua ceremonia e përfundimit të kursit EOD (Explosive Ordnance Disposal,) ceremonia e përfundimit të Kursit EOD Niveli II dhe Kursit Bazë të sigurisë fizike dhe menaxhimit të municioneve. Të pranishëm në këtë ceremoni ishin komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, përfaqësues nga Policia e Shtetit, përfaqësues nga zyra ODC si dhe pjesëtarë nga Shtabi i Komandës Mbështetëse dhe komandantët e strukturave të saj. Në fjalën e hapjes së këtij aktiviteti, komandanti Qendrës Stërvitore kolonel Ylli Zylaj theksoi rëndësinë e veçantë që kanë këto ceremoni duke u shprehur se: “Kursi EOD Niveli II, si dhe ai bazë i sigurisë fizike dhe menaxhimit të municioneve janë kurse funksionalë, nëpërmjet të cilëve realizohet formimi profesional i ushtarakëve të FA-së, duke i përgatitur pjesëmarrësit në rolin e Instruktorit EOD si dhe angazhimin dhe përgatitjen në pikëpamje të menaxhi-

mit e sigurisë së municioneve. Kurset e zhvilluara më parë për menaxhimin e municioneve dhe eksplozivëve janë drejtuar nga instruktorë të USCGM dhe GOLDEN WEEST, ndërsa ky kurs është monitoruar prej tyre.” Komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, gjatë përshëndetjes së tij, i cilësoi këto kurse tepër të rëndësishëm në veçanti kursin EOD Niveli II. “Nëpërmjet këtij kursi ne arritëm që të certifikojmë specialistët EOD në rolin e Instruktorit, të cilët do të zhvillojnë dhe ruajnë vazhdimësinë e këtyre kurseve në të ardhmen”, - u shpreh gjeneral brigade Xhebexhia. Këto kurse u zhvilluan me një impenjim dhe përkushtim të madh si në aspektin e përgatitjes profesionale si EOD të një niveli më të avancuar ashtu edhe nga ana instruktive dhe metodike. Në përfundim gjeneral Brigade Xhebexhia falënderoi në veçanti ekipin e instruktorëve për kontributin e dhënë deri tani në Komandën Mbështetëse. Në këtë kurs morën pjesë edhe kursantë nga Kosova si dhe nga Policia e Shtetit. Në përfundim të ceremonisë u shpërndanë certifikatat për të gjithë kursantët.



NATO ka nisur një projekt, në vendet anëtare, kundër dezinformimit dhe veprimtarive armiqësore të informacionit.

Në një njoftim për shtyp, NATO bën të ditur se do të ofrojë grante për ide të reja në fushën e informacionit, duke u mundësuar vendeve të Aleancës që të jenë më elastikë ndaj dezinformimit dhe veprimtarive armiqësore të informacionit. Teksa ka dhënë më shumë informacione për këtë nismë, Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi u shpreh se: "Dezinformimi dhe veprimtaritë armiqësore të informacionit janë kthyer në një fenomen shqetësues dhe për këtë NATO është e vendosur t'i kundërpërgjigjet këtyre fushatave. Nisma më e fundit e Aleancës është gjithashtu një mundësi e jashtëzakonshme për organizatat joqeveritare (OJF) shqiptare, universitetet, dhe çdo organizatë tjetër të shoqërisë civile. Divizioni i Diplomacisë Publike të NATO-s ka

Peleshi: NATO mbështet financiarisht çdo projekt novator për të luftuar dezinformimin dhe aktivitetet armiqësore të informacionit në shoqëritë tona



bërë një thirrje për të mbështetur financiarisht çdo projekt novator për të luftuar dezinformimin dhe aktivitetet armiqësore të informacionit në shoqëritë tona". Ndaj ministri

Peleshi i bën thirrje çdo OJF-je, universiteti apo organizate të shoqërisë civile në Shqipëri, me ide të reja dhe projekte inovatore, të cilët kanë afat deri më 10 maj 2022 të aplikojnë.

"DITA E VIZITORËVE TË SHQUAR"

"Dita e Vizitorëve të Shquar" për aktivitetin trajnues të përbashkët me palën amerikane OCS CL 65 FTX. Ky aktivitet u ndoq edhe nga Ambasadorja e SHBA-së në Shqipëri, znj. Yuri Kim, shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj, komandanti i AFA-së, gjeneral brigade Albert Mullai, Atasheu Ushtarak i SHBA-së, zyrtarë të Zyrës së Bashkëpunimit të Mbrojtjes (ODC) etj. Gjatë "Ditës së Vizitorëve të Shquar" u demonstruan veprime të përbashkëta për kryerjen e sulmit në nivel toge si dhe tërheqjes së të plagosurve dhe dhënies së ndihmës së parë në fushëbetejë. Gjatë FTX janë zhvilluar aktivitete të integruara në nivel skuadre dhe toge ndërmjet kursantëve tanë të KPO 22 dhe kadetëve të OCS CL 65. Aktiviteti përfshinte kryesisht tema taktike dhe lidërsip.

FTX do të mbyllet me analizën pas veprimit dhe me trajnim të inte-

Zhvillohet aktiviteti "Dita e Vizitorëve të Shquar"



guar të dy palëve të instruktorëve. Aktivitete të këtij lloji do të vijojnë edhe në të ardhmen, në kuadër të arritjes

së objektivave të transformimit të AFA-së dhe sistemit të arsimit profesional ushtarak.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjeneralmajor prof. asoc. Begaj, i shoqëruar nga komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji dhe atasheu ushtarak amerikan në vendin tonë CDR David Millner, inspektuan trajnimin që batalioni i Dytë i Këmbësisë (b2k), po zhvillon prej disa ditësh me ekspertët ushtarakë të Gardës Kombëtare të New Jersey-it.

Gjeneralmajor, prof. asoc. Begaj ndoqi nga afër demonstrime në të tre stacionet stërvitore: shëndetësi, përgatitje zjarri me mortaja të kalibrit 60 mm dhe 80 mm si dhe mirëmbajtjen e mjeteve të blinduara, gjithashtu u njoh nga ekspertët amerikanë me programin e aplikuar gjatë këtyre ditëve të trajnimit, me efektivet e b2k të Forcës Tokësore.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm adresoi një falënderim për të gjithë pjesëmarrësit në këtë trajnim dhe në mënyrë të veçantë ekipin e ushtarakëve amerikanë, për asistencën e tyre në rritjen e nivelit profesional të trupave të b2k, si bërthama e Grup Batalionit të Lehtë të Këmbësisë, dhe shprehu bindjen se ky trajnim, por edhe të tjerët që priten në vijim në kuadër të bashkëpunimit dypalësh me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, do të jenë shumë të vlefshme për trupat e Grup Batalionit të Lehtë të Këmbësisë, gjatë certifikimit të tyre në muajin shtator.

Gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj inspekton trajnimin e ushtarakëve të Forcës Tokësore nga Garda Kombëtare e New Jersey-it



Gjeneralmajor, prof. asoc. Begaj ndoqi nga afër demonstrime në të tre stacionet stërvitore: shëndetësi, përgatitje zjarri me mortaja të kalibrit 60 mm dhe 80 mm si dhe mirëmbajtjen e mjeteve të blinduara, gjithashtu u njoh nga ekspertët amerikanë me programin e aplikuar gjatë këtyre ditëve të trajnimit, me efektivet e b2k të Forcës Tokësore.



ARSIMIMI

Në Qendrën e Arsimimit Profesional të Nënoficerëve, filloi kursi i 72-të Fillestar i Nënoficerit, i cili do të zhvillohet prej një periudhë 5-javore.

Në këtë kurs do të ndjekin procesin mësimor 54 kursantë me gradën UPR - IV të ardhur nga strukturat e FA-së, ku tre prej tyre janë personel femër.

Objekti i këtij kursi, është hedhja e bazave për karrierën e nënoficerit, marrja e njohurive teorike dhe ato praktike, për drejtimin e grupit dhe niveleve të njehsura me të, shkëputja nga përgjegjësia individuale në aftësinë dhe përgjegjësinë si drejtues grupi.

Në Qendrën e Arsimimit Profesional të Nënoficerëve, filloi kursi i 72-të Fillestar i Nënoficerit



Takim kushtuar 26-vjetorit të krijimit të SHKURSH

“Të jesh veteran i Ushtrisë është një titull nderi”

Në ambientet e auditoriumit u organizua 26-vjetori i krijimit të Shoqatës së Ushtarakeve në Rezervë. Të pranishëm në këtë ceremoni ishin dhe përfaqësues të kësaj shoqate nga rrethe të ndryshme të Shqipërisë. Presidenti i shoqatës z. Thoma Konduri, pasi falënderoi pjesëmarrësit, kujtoi vështirësitë që ka kaluar në këto vite rrugëtimi kjo shoqatë dhe mbështetjen e gjerë që ka gjetur ajo në të gjithë Shqipërinë. Më pas fjalën e mori presidenti i nderit zoti Zydi Kroj, i cili solli kujtime nga çastet kur kjo shoqatë po hidhte hapat e saj të parë.

Liliana Konomi Mero, si përfaqësuese e ish-ushtarakëve femra falënderoi për bashkëpunimin dhe mjedisin e ngrohtë të krijuar në rrugëtimin e tyre të përbashkët.

Z. Bujar Shtylla solli një sintezë të punës së bërë në këtë periudhë mbi çerekshkullore.

“Të jesh veteran i Ushtrisë është një titull nderi”, -ishin fjalët e z. Sali Onuzi, i cili me tej do shprehej se:

“Puna e Shoqatës sonë, sidomos në aspektin e të drejtave ekonomike të ushtarakëve në rezervë, ka qenë një punë e madhe, e vështirë, heroike. Me shumë mund e sakrificë, ajo ia ka dalë të jetë një mbrojtëse e të drejtave tona. Por ne nuk jemi thjesht një shoqatë që kujdeset vetëm për çështjet e saj organizative, duke bërë një punë të mbyllur. Ushtarakët kanë treguar që në



vitet e para të reformave, disa nga të cilat prekën rëndë të drejtat e tyre dhe të popullit, se ata nuk pajtoheshin me padrejtësitë. Le të kujtojmë këtu përballimin e situatës së rëndë që kapi vendin në vitet 1996-1998.

Shoqata jonë ka qenë e është edhe një subjekt aktiv i edukimit patriotik të anëtarëve të saj dhe ndikimi në shoqërinë shqiptare. Ashtu siç nuk ka ushtri pa edukim patriotik, edhe shoqata jonë nuk mund të bëjë pa këtë. Oficeri aktiv e ne rezervë

është i lidhur ngushtë me Atdheun, me lirinë dhe pavarësinë e tij. Ky edukim patriotik është një armë e fuqishme.

Ne po e shohim se ç' ndodh në Ukrainë. Qëndresa e saj është mburjtur së pari me patriotizëm, të një populli që lufton e qëndron për atdheun e lirinë e tij, me një udhëheqje e një president që janë bërë shembull patriotizmi anekënd Botës, kundër një ushtrie të armatosur deri në dhëmbë, por që kishte mbivlerësuar rolin e teknologjisë së lartë ushtarake. Dje ishte 7 prill, dhe është rasti të kujtojmë po edhe të rivlerësojmë më tej shembullin negativ të ish-mbretit, Ahmet Zogut, që as dy ditë nuk qëndroi në Shqipëri pas sulmit dhe pushtimit fashist Italian. Pas luftës në Ukrainë është krijuar e po krijohet një situatë tjetër gjeopolitike dhe e marrëdhënieve ndërkombëtare. Kjo luftë e ashpër nuk dihet se si dhe kur do të përfundojë. Ajo është një rrezik që mund të ndezë konflikte edhe më të mëdha. Në këto situata, detyra jonë është të jemi të bashkuar, të jemi përkrah Ministrisë së Mbrojtjes e Shtabit të Përgjithshëm, përkrah shtetit tonë shqiptar, për të përballuar çdo situatë, qoftë ekonomike, politike apo edhe ushtarake. Nuk duhet ta nënvlefësojmë punën tonë në këtë drejtim,

duke menduar se jemi në pension e lirim e jemi të moshuar. Ne jemi betuar se sa të jemi gjallë do të jemi në këmbë për Shqipërinë, do të bëjmë çdo gjë që kemi mundësi, edhe me përvojën tonë, edhe me aftësitë tona, po edhe me fjalën e urtë, që me të drejtë Homeri e llogariste si tiparin më thelbësor të të moshuarve. Këta që drejtojnë Shqipërinë sot janë shokët po edhe djemtë e vajzat tona, nipërit e mbesat tona. Ka shumë rëndësi t'u jemi pranë atyre me këshilla, mendime e çdo gjë që situata mund të ketë nevojë.

Por, edhe të dimë të përçojmë në masën e njerëzve arritjet e Shqipërisë së sotme, si një vend i NATO-s, që vjet pati presidencën e OSBE-së dhe tani, për dy vjet është e do të jetë anëtar i Këshillit të Sigurimit të OKB-së, që është bashkë-penëmbajtës aty me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që ka dërguar reparte ushtarake në përbërje të trupave të NATO-s, ku ka qenë e nevojshme, që priti me bujari vëllezërit e motrat e tij, shqiptarë të Kosovës më 1999 dhe strehon ish-luftëtarët iranianë, emigrantët afganë, dhe tani edhe ato ukrainas, duke u siguruar kushte sa më të mira dhe duke u bërë shembull pozitiv edhe për disa vende të pasura të Botës.

Ky edukim patriotik kërkon që

ne veteranët e ushtrisë të jemi edhe më aktivë në mbrojtjen e historisë së LANÇ dhe të historisë së Ushtrisë sonë popull-ore dhe të Forcave të Armatosura sot, përkundër disa qëndrimeve nihiliste dhe antihistorike, që artikulojnë disa tipa tashmë të njohur për negativizmin e tyre. Ushtria jonë ka pasur edhe drejtues dhe historianë të zotë. Po edhe në kohën tonë Shqipërisë sonë nuk i mungojnë ata. Madje po shtohen, krahas një brezi të vjetër (anëtarë të Institutit të studimeve të Historisë ushtarake, të drejtuar nga prof. dr. Proletar Hasani) kanë ardhur në skenë shkencëtarë të rinj si Marenglen Kasmi, Kristaq Xharo (me shkrimet e tij studimore për aspekte të veçanta të sigurisë) po dhe autorë të rinj ushtarakë si Zeno Jahaj, Agron Berdaj, (me librin e tyre "Përtej shtrëmbërimeve: Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare"), pedagogia e Historisë Ushtarake të Akademisë së FA-së, znj. Enkeleida Tyrku, ose Dilaver Goxhaj, shoku ynë që luftoi e drejtoi në radhët e UÇK-së, që shkruan vazhdimisht, dhe vetëm javën e fundit dy artikuj në "Dita", për luftën e Selenicës në 1943 (duke nxjerrë në shesh gënjeshtër e ballistëve dhe luftën e çetave partizane) dhe për vlerën e fortifikimit të dikurshëm, që e sulmuan



ultrapacifistët (si të panevojshëm e të dëmshëm) dhe që e shkatërruan pa dhimbje individualistë e arrivistë për mikropërfitime, ndofta edhe për dëmtime të qëllimshme armiqësore. Unë besoj se organet kompetente do të interesohen që ato Qendra Zjarri që kanë shpëtuar të mirëmbahen e ruhen, t'i kemi për çdo të papritur e kundër çdo rreziku. Ato, siç thotë populli, nuk kërkojnë ujë e bukë.

Ja, po shohim se sa i rëndësishëm është fortifikimi në Ukrainë: banorët u futën nëpër metro e podume të palla-teve për t'i shpëtuar bombardimeve të ushtrisë pushtuese ruse. Po nuk shikon nga ato që japin mediat, të ketë e të shfrytëzohen fortifikime moderne, shihen vetëm disa qendra zjarri si ato të luftës së parë e të dytë botërore, ndërtoar shpejt e shpejt, me drurë e dhe, dhe ku?, në një vend fushor, ku fortifikimi do të bënte shumë punë. Historia ushtarake është laborator i oficerit, thonë filozofët e Luftës e të ushtrive. Ajo duhet shkruar po dhe studiuar me kujdes për të përfituar përvojë, kulturë dhe aftësi drejtimi e luftimi. Prandaj mendoj se Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm i FA-së duhet ta rishikojnë programin e historisë e të gjeografisë ushtarake në Akademinë tonë të FA-së, por edhe në kurset e ndryshme të kualifikimit. Në këto drejtime të edukimit atdhetar ne mund e duhet të bashkëpunojmë me Organizatën e Veteranëve e të pasardhësve të LANÇ-it ("Nderi i Kombit") dhe me Organizatën Kombëtare të Dëshmorëve të Atdheut, që kanë një përvojë të pasur shumëvjeçare. Në mbyllje u shpërndanë "Certifikata Mirënjohjeje" për gjithë kontributorët e kësaj shoqate.

Përfaqësues të Shoqatës së Veteranëve të Flotës Detare "Detaria Shqiptare" realizuan një vizitë në Komandën e FD-së

Anëtarë të Kryesisë së Shoqatës "Detaria Shqiptare", ish-komandantë të Flotës Detare, bashkë me përfaqësuesit e shoqatës "Detaria Shqiptare", zotin Bujar Bardhi, zhvilluan një vizitë në Komandën e Forcës Detare, të cilët u pritën nga komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra dhe disa kuadro të shtabit.

Fillimisht veteranët e Flotës i uruan suksese në detyrën e komandantit të Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastrës, bashkë me personelin e Forcës Detare.

Gjithashtu kundëradmiral Agastra u uroi mirëseardhjen në Komandën e Forcës Detare dhe i siguroi se komanda e Forcës Detare do jetë e hapur vazhdimisht për të gjithë ata që kanë shërbyer në Flotën tonë Detare.

Gjatë takimit ish-komandantët u njohën me punën që po bëjnë aktualisht efektivet e Forcës Detare për realizimin e detyrave të përditshme në të cilën sollën përvojën e tyre në çështje të caktuara.

Gjithashtu komandant Agastra i njohu miqtë e Forcës Detare me disa synime kryesore që kanë të bëjnë me reformimin dhe modernizimin e Forcës Detare. Veteranët shprehën kënaqësinë e tyre për çdo arritje të Forcës sonë Detare. Për punën, aktivitetin dhe bashkëpunimin e shoqatës "Detaria Shqiptare", në ruajtjen dhe transmetimin e traditës së detarëve, komandant Agastra i akordoi shoqatës "Certifikatë Mirënjohjeje".





Në mjediset e stacionit Meteorologjik Ushtarak, Tiranë, u zhvillua ceremonia e dhënies së "Certifikatës së mirënjohjes", akorduar nga komandanti i Forcës Ajrore gjeneral brigade Ylli Pulaj me rastin e daljes në pension të z. Gëzim Meçaj, i cili mbante detyrën e shefit të stacionit meteorologjik Korçë.

Mbas përshkrimit të karrierës së z. Meçaj, nga drejtuesi i stacionit meteorologjik Tiranë, Komandanti i Forcës Ajrore vlerësoi kontributin e tij si ushtarak dhe më pas si punonjës civil në Forcat e Armatosura dhe specifikisht në Forcën Ajrore.

Gjeneral Pulaj falënderoi për shërbimin dhe sakrificat, për eksperiencën e dhënë dhe profesionalizmin e treguar, duke i dorëzuar kështu z. Meçaj certifikatën me motivacion: "Falënderim për përkushtimin dhe kontributin e shquar, të dhënë gjatë karrierës në Shërbimin Meteorologjik Ushtarak, në Forcën Ajrore".

Në fjalën e tij z. Gëzim Meçaj falënderoi gjeneral brigade Ylli Pulaj për vlerësimin, duke shprehur në të njëjtën kohë emocionet e veçanta për këtë ceremoni dhe respektin e treguar me rastin e daljes në pension. Ceremonia u mbyll me një foto të përbashkët.

Gjeneral brigade Pulaj: Falënderim për përkushtimin dhe kontributin e shquar, të dhënë gjatë karrierës në Shërbimin Meteorologjik Ushtarak në Forcën Ajrore



Gjeneral brigade Pulaj jep "Certifikatë mirënjohje" për punonjës të Forcës Ajrore me rastin e daljes në pension



Më herët, gjeneral Pulaj ka vlerësuar me "Certifikatë mirënjohje" z. Novruz Leka, z. Sokol Duka, dhe z. Hasan Myrtezaj, të cilët në të njëjtën periudhë kanë dalë në pension, duke i shprehur atyre

mirënjohje për kontributin dhe përkushtimin e dhënë gjatë viteve që kanë shërbyer si pjesëtarë të Forcës Ajrore si dhe iu ka uruar atyre shëndet dhe jetë të gjatë pranë familjarëve të tyre.



“Ditë e Hapur”

Bashkëpunim me gjimnazin “Qemal Stafa”

Forca Tokësore

Në kuadër të 13-vjetorit të anëtarësimit të vendit tonë në NATO dhe rritjes së bashkëpunimit me komun-itetin civil, sot Forca Tokësore (FT) në bashkëpunim me gjimnazin “Qemal Stafa”, organizoi aktivitetin “Ditë e Hapur”.

Ky aktivitet, i zhvilluar në ambientet stërvitore të Regjimentit të Operacioneve Speciale (ROS) të Forcës Tokësore, pati si vizitorë të tij rreth 100 nxënës dhe stafin pedagogjik të njërit nga gjimnazet më të mira të Tiranës siç është gjimnazi “Qemal Stafa”.

Për rreth 2 orë, gjimnazistët patën mundësinë të shikonin dhe preknin nga afër armatimin, pajisjet dhe teknikën që përdor efektiviteti i ROS.

Më tej, ata vizituan edhe disa prej stacioneve stërvitore siç ishin kulla

e alpinizmit, fshati taktik, poligoni i qitjeve luftarake dhe këndi i mbi-jetesës, të cilat lanë mbresa të veçanta tek të gjithë nxënësit.

Më dëshirën e madhe, për të përjetuar adrenalinën që të jep hedhja me litar nga kulla e alpinizmit, një pjesë e tyre guxuan të bëhen pjesë e kësaj sfide.

Axhenda e “Ditës së Hapur” vijoi, edhe me një program artistik me

pjesëmarrjen e këngëtarëve të Qendrës së Kulturës Mediave dhe Botimeve të Mbrojtjes, Saimir Braho dhe Redon Makashi.

Në këtë aktivitet, mori pjesë gjithashtu edhe personeli i Qendrës së Personel Rekrutimit (QPR), të cilët ofruan për gjimnazistët e “Qemal Stafës”, informacionin e nevojshëm se si të bëhen pjesë e Forcave të Armatosura.



“Sikur të isha djalë?”

ANJEZA MUSOLLARI
Shefe e Sektorit të Botimeve

Kush është më mirë të lindë - një vajzë apo një djalë?

Kush është më i mirë - një djalë apo një vajzë?

Pse nuk ka mjaft gra në planet?

Në fund të fundit, ju nuk do t'i tregoni një fëmijë të vërtetën që ju vetë nuk ju pëlqen. Gjatë shtatzënisë, megjithëse u thashë të gjithëve se për mua nuk kishte rëndësi se kush do të më lindte, unë vetë shpresoja fshehurazi për një djalë. Epo, për t'i sjellë gëzim babait, në mënyrë që të ketë një pasardhës. Për disa arsye, nuk mendoja fare për një pasardhës të nënës sime. Dhe po, nuk më interesonte vërtet për veten time. Prandaj linden mendime të tilla. Por ju nuk mund t'ia shpjegoni këtë një fëmijë - ata nuk do ta kuptojnë, pavarësisht sa shumë përpigjeni. Dhe shija e pakëndshme me siguri do të mbetet. Mbjaj mendshme që babai im më tha se donte edhe një djalë. Dhe sapo i lindi vajza, ai rruante mustaqet, sipas premtimit që i kishte bërë vetes. Nga rruga, ai nuk ka fare mustaqe, kështu që për të, që të rruajë mustaqet e tij është një hap shumë vendimtar. Më pas dëgjoja shpesh se si, në bisedat me miqtë, ai fliste për familjen tonë “mbretërinë e mbiemrit”, që do të thotë se ai ishte i vetmi burrë këtu. Tani jam pothuajse e sigurt se ai nuk donte të thoshte asgjë të keqe, por atëherë ishte e pakëndshme për mua të dëgjoja gjëra të tilla. Sikur e kam fajin që nuk kam lindur vajzë. Nga rruga, një herë pashë filmin “Sex and the City”, dhe atje burri i njëres prej heroinave pas lindjes së vajzës së saj të dytë deklaroi me krenari diçka të tillë: “Unë jetoj si në një kopsht lulesh! Në fund të fundit, janë pikërisht fjalë të tilla që e lejojnë vajzën të jetë krenare që është vajzë. Dhe gjithë jetën time të pavetëdijshme u pendova që nuk linda djalë. Vetëm në sfondin e problemeve të tyre të të rriturve, vitet e tyre të fëmijërisë do të duken kaq të ndritshme. Sipas një sondazhi sociologjik, ku morën pjesë rreth 2 mijë persona në moshë pune, 2/3 e qytetarëve të vendit tonë mendojnë se më mirë të lindësh djalë sesa vajzë. Në të njëjtën kohë, ata përmendin faktet e mëposhtme si përparësitë më të rëndësishme të burrave ndaj grave:

1. Burrat e kanë shumë më të lehtë për t'u zhvilluar dhe për të arritur sukses në karrierë. Ata fitojnë shumë më tepër se gratë. Për ta është më e lehtë të gjejnë një punë prestigjioze

Diku më ra në sy kjo përgjigje:

- Po t'a kisha pasë në dorë do t'a grisësja çarçafin dhe nuk do të lejsha femën pa shkollë, pse grueja është themeli i shoqërisë njerëzore, pse ajo është burim i moralit, pse ajo është nyja e shenjtë e qenies, pse ajo e mbjell farën e dashurisë vëllazërore në mes të njerësve. E kur ajo lihet mbas dorë vuen e tanë shoqëria njerëzore.

Në faqen 78 pashë këtë shënim si përfundim i një mendimit të shfaqun ma sipër:

Unë, po t'isha djalë, do t'i tregojsha botës mashkullore se dora që përkund djepin është ajo që e rrotullon boshtin e fatit të njerzisë, sepse ajo dhe vetëm ajo e drejton jetën kah horizontet e ndritshme. Por mjerisht s'jam djalë dhe si femër nuk mundem me e nxjerrë zatin.

Kah mbarimi vuna re:

Na, femrat Shqiptare, jemi krijesa të vorfëna që tue kangëtue, si të trenueme, shkojmë symbyllazi drejt gremisë, drejt vorrit që na përgatisin të tjerët dhe na shtynjë me u përplasë mbrenda. Po. Na duhet të jemi të qeshura e gastore për t'i kënaqë kapricjet e burrave, lypset të jemi pa zemër e pa shpirt për t'i ngopë dëshirat e atyne që na kanë monopolizue. Por edhe në paçim zemër e shpirt, këta lypset të fonksjo nojnë vetëm simbas andjes së atyne që na kanë robnuet e jo për ata që na mund të dashunojnë. Oh fatkeqësi! Sa e sa breza femrash, që erdhën para nesh, u banë viktimet e këtij zakoni të egër dhe flia e asaj mendësie që kish për të vetmin qëllim të kënaqi kapricjet e një turme injorante, sunduese mbi fatin dhe jetën e atyne femra ve të mjera.

Nji „ta! ta!“ e fortë e buris s'automobilit dhe të truemit e shoforit me za të egër, më shqitën nga fletori i Dijes.

dhe fitimprurëse.

2. Burrat mund të mos i bëjnë fare punët e shtëpisë, para martesës - nëna e tyre e bën këtë për ta, dhe pas martesës - gruaja. Një burrë mesatarisht shpenzon 30 minuta duke gatuar çdo ditë, dhe një grua kalon një të tretën e jetës së saj në kuzhinë. 3 milion burra, nuk e dinë se çfarë do të thotë të mbash një fëmijë në bark për 9 muaj, të lindësh dhe të ulesh në leje lehonie për 3 vjet.
4. Burrat nuk kanë pse të shqetësohen për pamjen e tyre. Ata nuk kanë nevojë të bëjnë manikyr, pedikyr, maska për fytyrën, kujdes për flokët, heqjen e vetullave... Kur sheh një këmishë ose këpucë të bukura në një dyqan, një burrë nuk do të shpenzojë paratë e tij të fundit për to. Burrat nuk i pëlqejnë blerjet.
6. Burrat nuk e kanë të nevojshme të fshehin moshën e tyre, ata nuk janë të mërzitur për shkak të shfaqjes së rrudhave dhe flokëve të thinjura.
7. Reputacioni mashkullor nuk përkeqësohet pas marrëdhënies së parë seksuale. Ata mund të martohen në moshën 30-vjeçare, ndërsa askush nuk do të thotë se ai nuk është më i ri. Miqtë vetëm do t'i kenë zili, dhe të afërmit do të jenë krenarë.
8. Burrat e përjetojnë më lehtë divorcin dhe kanë tre herë më shumë gjasa se gratë të rimartohen.
9. Kur sqaron marrëdhëniet me dikë një burrë mund të mbrohet me grushte, dhe askush nuk do ta quajë hysterik.
10. Burrat nuk kanë nevojë të ndryshojnë mbiemrin pas martesës, të gjithë anëtarët e familjes mbajnë mbiemrin e tij. Një burrë u jep fëmijëve të tij jo vetëm jetën, por një mbiemër dhe patronim. E çdo të kisha bërë ndryshe?! Kur prej shekujsh kërkohet barazi mes llojit të racës njerëzore.

Për shumë njerëz të jesh femër do të thotë të jesh përgjegjëse për çdo lloj pune që ka lidhje me pastrimin, gatimin, rritjen e fëmijëve dhe kaq!

Për shumë njerëz roli i femrës vazhdon të jetë i barabartë me një krah pune dhe asgjë më shumë.

Për shumë njerëz një femër duhet të durojë çdo gjë pa bërë zë, pa ngritur krye dhe thjeshtë t'u nënshtrohet të tjerëve.

Ky është koncepti më i gabuar që dikush duhet të këtë për definicionin FEMËR.

Një femër është shumë më tepër se aq! Një femër është një qenie po aq e fortë sa një mashkull për të mos thënë që është dhe më e fortë.

Një femër është ajo e cila përballet me çdo problem në shtëpi dhe e zgjidh duke mos e lënë partnerin e saj të kuptojë që ai problem ka ekzistuar ndonjëherë. Një femër është ajo e cila pavarësisht sesi ndihet nuk i le të tjerët të kuptojnë se çfarë ka. Një femër është ajo pa të cilën meshkujt do të ishin të mjerë. Është ajo e cila fal ngrohtësi kur ke nevojë, të mbështet atëherë kur ti e ndjen se e ke të gjithë botën kundër, nuk të le të marrësh vendime të gabuara për të cilat mund të pendohesh me vonë. Pra një femër është “superheroi” që fshihet pas sukseseve të një mashkulli. Një femër është ajo e cila pas çdo zhgënjimi, lëndimi apo humbjeje ngrihet më e fuqishme se më parë...

Nëse do më duhej ta krahasoja një femër me diçka do e krahasoja me një fenix, i cili digjet kthehet në hi dhe rilind më i fortë, më i bukur dhe kryelartë. U përpoqën ta përdhosin, ta bëjnë të ndihet inferiore ndaj faktit që është ‘e brishtë’.

Por ajo qëndroi e paepur ndaj çdo suferine sepse është FEMËR !



**INTERVISTË ME
GJENERAL BRIGADE
ASTRIT JAUPIN
ISH-KOMANDANT
I FORCËS AJRORE**



Udhëtimi 71-vjeçar i kaltërsive Shqiptare

Intervistoi:
Shefe e Sektorit të Botimeve,
Anjeza Musollari

Gjeneral brigade Astrit Jaupi (ish-komandant i Forcës Ajrore) me një eksperiencë të gjatë si aviator dhe drejtues force, në kremtimin e 71-vjetorit të krijimit të Armës së Aviacionit vjen për lexuesin me një rrëfim historik të jetës së tij dhe aktivitetit në vite të aviacionit luftarak shqiptar.

Si ka nisur udhëtimi juaj drejt kaltërsive?

Kam mbaruar shkollën 8-vjeçare dhe të mesmen ekonomike në qytetin e Korçës. Më pas kërkoja për të vazhduar Shkollën e Bashkuar dhe në shtator të vitit 1971 fillova shkollën e aviacionit për pilot në Vlorë. Në vitin 1972 bëmë fluturimin e parë me 'Tip 61' për stu-

dentët. Në nëntor të vitit 1973 ne vazhduam studimet në Republikën Popullore Kineze dhe fluturimet reaktive i bëmë për herë të parë në Kinë me 'Mig 17'. Në vitin 1974 u ktheva dhe u diplomova oficer me titullin pilot, ku menjëherë u emërova në Kuçovë me avionin 'Mig 15'. Më 2 prill 1976 u nisëm për studime në Republikën Popullore të Kinës për fluturim me avionin reaktiv luftarak 'Mig 19'. Në dhjetor të vitit 1976, pasi u ktheva si pilot në 'Mig 19', u emërova në regjimentin e ri të Gjadrit në Lezhë (Zadrimë). Pas një viti na përzgjedhën mes shumë të tjerësh, tre pilotë për avionin 'Mig 21', kalimi i të cilit ishte bërë jashtë shtetit ne e realizuam në Zadrimë.

Nga viti 1978 dhe deri në vitin 2003 unë fluturova me 'Mig 21' edhe si komandant i Forcës Ajrore, dhe si gjeneral. Pas vitit 2005, vit kur u mbyll aviacioni luftarak shqiptar, unë vazhdoja të shkoja në Farkë të fluturoja me helikopter si i vetmi regjiment që i rezistoi Forcave Ajrore, mjaft i fuqizuar sot, dhe është krenaria jonë.

Një jetë e tërë mes tokës dhe qiellit. Kush ishin disa nga etapat e karrierës suaj?

Gjatë karrierës time nga pilot i thjeshtë, që në Gjadër unë arrita të bëhem komandant i skuadriljes 'Mig 21', në vitin '92 u emërova zëvendës komandant i aviacionit në Ministrinë e Mbrojtjes. Më pas shkova për studime në Turqi në Akademinë e Luftës së Forcave Ajrore. Në shtator të vitit 1997 u emërova zëvendës komandant i Forcave Ajrore. Në fund-gushtin e vitit 2000, me krijimin e strukturave të reja si Forca Tokësore, Forca Detare,



Forca Ajrore, Komanda Mbështetëse, u emërova komandant i Forcave Ajrore, si i pari i Forcave Ajrore, sepse deri atëherë kishin qenë të ndarë aviacioni dhe MKA më vete. Pasi mora këtë detyrë në kushte të vështira, pasi repartet ishin në mbarim e sipër pas ngjarjeve të vitit 1997, duhej një punë e madhe për të ringritur repartet dhe për të mbajtur gjallë aviacionin luftarak.

Në vitin 2001 mora gradën gjeneral brigade dhe vazhdoja si komandant i Forcave Ajrore deri në vitin 2008, si i vetmi gjeneral me tre mandate.

Një rrugëtim i gjatë, i vështirë me plot sakrifica personale dhe familjare. Aviacioni ka 43 dëshmorë, nuk ka grup që të mos ketë një shok të vrarë. Dhe duke qenë ky rrezik dhe këto vështirësi e bënë këtë zanafillë të fortë. Ne kurrë nuk e kemi llogaritur jetën. Edhe familjet tona jetonin me ankthin tonë. Çdo ditë e re e jona ishte një fillim jete i ri.

71 vite nga krijimi i Armës së Aviacionit Luftarak. Cilat janë etapat nëpër të cilat kaloi ai?

Më 24 prill të vitit 1951 është krijuar Arma e Aviacionit, pra kemi 71 vite rrugëtim të cilin unë do ta ndaja në tre faza të rëndësishme.

Faza e parë ka qenë krijimi i tij. Që të krijonte aviacion pas luftës kuptohet sa e vështirë ishte, duke ditur mungesën e informacionit që kishin shqiptarët e atyre viteve. Megjithatë aviatorët e parë shqiptarë i takojnë vitit 1946.

Pilotët e parë janë zgjedhur nga forcat partizane,

nga oficerët e rinj të shkollës së atëhershme.

Ndër ta mund të përmendim pilotin Niko Hoxha, Edip Ohri, Fari Bubs, Zyhd Rada, Sazan Xhelo, Irakli Grazhdani etj. Grupi i parë kanë shkuar në ish-Jugosllavi. Babaç Faiku, Hamit Ulqinjaku, Daut Gurabardhi (inxhinieri i parë i aviacionit) në Shqipëri. Në këtë kohë marrëdhëniet diplomatike me ish-Jugosllavinë u prishën dhe pilotët tanë u larguan për në Rusi.

Në Jugosllavi ne kemi dhe pilotin e parë që humbi jetën në vitin 1948 Ibush Vokshi nga Durrësi, i cili ra dëshmor.

Kjo rrugë krijimi ishte me këtë grup pilotësh, teknikësh të cilët në 1950 u kthyen dhe në 1957 erdhën avionët e parë nga Rusia 'PO 9' luftarakë turbo-helike, u montuan tek ne nga rusët, u bënë kontrollet teknike dhe fluturimet e para dhe me ven-

dim të Këshillit të Ministrave, më 24 prill u formua skuadrilja e parë e aviacionit shqiptar me komandant Babaç Faikun, shef shtabi Peço Polena. Si organikë ishte e madhe, por ende njerëzit nuk ishin kthyer nga studimet në Bashkimin Sovjetik. Menjëherë sapo u dha vendimi, piloti Peço Polena bëri dhe fluturimin e parë demonstrues mbi Tiranë. Mbas vitit 1951 filluan të vijnë specialistë dhe inxhinierë dhe në vitin 1955 vijnë rreth 30 avionë 'Mig 19'.

Në vitet 1960 patëm dhe dy aviatorë studentë të rrëzuar në ish-Bashkimin Sovjetik, të cilët u shpallën Dëshmorë të

Atdheut.

Traktati i Varshavës, para viteve 1960, i fali Shqipërisë një skuadrilje me 'Mig19' të sofistikuar



me radarë dhe mjete moderne të navigimit, të cilët u vendosën në Rinas, ku sapo ishte krijuar regjimenti me pilotët më të mirë që kishin mbaruar në Bashkimin Sovjetik. Në atë kohë erdhi dhe avioni i parë qeveritar si dhuratë për qeverinë shqiptare. Fluturimin e parë me të e bëri Babaçe Faiku dhe Hamit Ulqinaku si pilotë dhe kryeinxhinier Daut Gurabardhi (inxhinieri i parë dhe i talentuar i aviacionit shqiptar). Kjo ishte periudha e modernizimit të aviacionit pas viteve '60.

Çfarë ndodhi me prishjen e marrëdhënieve të Shqipërisë me ish-Jugosllavinë?

Studentet tanë pas prishjes së marrëdhënieve me ish-Jugosllavinë u larguan drejt Kinës, pra rreth viteve 1961-1962. Gjatë kohës që kthehen nga Kina, Shqipëria po përgatitej për të hapur shkollën e aviacionit dhe, më 11 maj 1962, u hap shkolla e parë e aviacionit shqiptar në Vlorë, ku komandant u emërua Babaçe Faliku, i cili drejtonte avionin qeveritar dhe ishte njëkohësisht dhe komandant i shkollës.

Filloi Republika Popullore Kineze të dërgonte avionët 'Mig 19', erdhën skuadrilje të tëra, u fuqizua regjimenti i Kuçovës me tre skuadrilje me 'Mig 19' po kështu dhe regjimenti i Rinasit me tre skuadrilje me 'Mig 19'.

Në vitin 1974 u krijua regjimenti i Gjadrit me dy skuadrilje 'Mig 19' dhe 'Mig 21'. Një zhvillim mjaft i madh i këtyre viteve.

Në vitin 1976 erdhën dy skuadrilje të reja me 'Mig 19', dy skuadrilje me silurues, topa 57' elektrike moderne. Janë ndihmat e viteve 1974-1976 që u montuan në Shqipëri, këto ishin dhe ndihmat e fundit, siç ishim dhe ne studentët e grupit tim të fundit që studi-uam në Kinë. Në periudhën e dytë patëm një zhvillim të madh të modernizimit të aviacionit, stërvitje të mëdha, u krijua uzina e aviacionit, si një uzinë moderne, të cilën nuk e kishin as vendet e tjera të Ballkanit. Në Kuçovë kishim 2 teste të motorëve të avionëve që bënë kolaudimin (siç e quani ju të rinjtë sot). Në vitin 1968 vijnë

40 helikopterë 'Mig 4', të cilët u vendosën në Farkë në një infrastrukturë e cila linte shumë për të dëshiruar, por komandanti i parë i saj, Çelo Musai, që ishte më shumë se një profesionist, së bashku me bashkëpunëtorët e tij të Xhenios krijuan atë Farkë që shohim sot.

U rrit shumë dhe rëndësia e helikopterëve, sepse ata kryenin dhe detyra të ndryshme në shërbim të bujqësisë, sidomos në vitet 1967 ndihmuan në transportin e gjeneratorëve elektrikë, sepse ishte koha që po realizohej elektrifikimi i vendit, merrnin pjesë në shuarjen e zjarreve. Rreth viteve '80 me prishjen e marrëdhënieve me Kinën tek ne filluan dhe problemet me pjesët e këmbimit të avionëve, numri i fluturimeve u zvogëlua, nga 50-100 orë fluturim në vit ky numër ra në 15 orë fluturim në vit, përveç instruktorëve që vazhdonin me rekordet e tyre të rinjtë ishin të kufizuar.

Në këtë moment kemi edhe fillimin e etapës së rënies, ne teknikë kishim, dhe madje shumë të aftë, por s'kishim pjesë këmbimi, ore fluturimi, harxhim karburanti...në një orë harxhohej 2000 litra karburant, i cili mbulohej nga aviacioni.

Pas viteve '90-'92 kemi dhe rënien më të madhe me shkurtimin e personelit, organikës, teknikës. Deri në vitin 2006 aviacioni shqiptar pati një ngërç të madh për sa i përket funksionimit të tij dhe unë kam qenë në një periudhë të vështirë si komandat, kur me strukturën që u bë u mbyll regjimenti i Gjadrit dhe Kuçovës. Farka në atë kohë ishte shkurtuar për shkak të mos funksionimit të saj prej kohësh. Këto situata ndikuan fuqishëm tek unë si drejtues dhe profesionist.

Si e shihni sot Forcën Ajrore?

Lumturohem tek shoh zhvillimet e saj në infrastrukturë dhe armë. Sot aleanca jonë e përbashkët NATO po bën



investime të mëdha që patjetër do të zhvillojnë më shumë aviacionin tonë ushtarak. Dhe me këtë rast dua të inkurajoj gjithë të rinjtë, që duan të aderojnë në forcat ajrore, ta bëjnë me zemër dhe dashuri, sepse është adrenalinë dhe përkushtim. Sukses pilotëve të rinj dhe drejtuesve të tyre në këtë rrugëtim të vështirë dhe plot sfida!

71-vjetori i krijimit të aviacionit luftarak

Nderim për “Shqipet e qiellit Arbëror”

Shoqata e aviatorëve në rezervë organizon aktivitete të vazhdueshme në funksion të misionit të saj. Në kuadër të festës së aviacionit (24 prill) u zhvillua ceremonia e dhënies së titullit “Qytetar Nderi” i Selenicës, për Lulo Musai (pas vdekjes), propozuar nga kryesia e shoqatës. Ceremonia u zhvillua tek Rrapi i Mesaplikut (vendlindja e Lulos). Lulo Musai, ish-partizan, i specializuar dy herë si pilot në ish-Bashkimin Sovjetik, pilot luftarak i klasit të parë, ish-komandant i parë i regjimentit luftarak të helikopterëve, Farkë. Në ceremoni morën pjesë anëtarë të shoqatës, veteranë të aviacionit, familjarë, funksionarë të bashkisë Selenicë, bashkëfshatarë, pilotë aktivë të Bazës Ajrore Farkë etj. Fjalën e rastit e mbajti nënkryetari i shoqatës aviatorëve, ish-pilot i këtij regjimenti z. Sami Guzina. Përshëndetën Kryetari i shoqatës gjeneral brigade (R) z. Astrit Jaupi, ish-kryeinxhinier i regjimentit, z. Tajar Ramadani, kryeplaku i fshatit, komandanti i bazës Ajrore Farkë kolonel Julian Dulemata dhe kryetari i bashkisë, Selenicë z. Pëllumb Binaj, i cili i dorëzoi dhe titullin “Qytetar Nderi” vajzës së Lulo Musait, Pranverës, e ardhur enkas nga SHBA-të. Njëkohësisht, më 22 prill, shoqata e aviatorëve, si çdo vit organizoi një takim jubilar kushtuar 71-vjetorit të krijimit



të aviacionit tonë luftarak. Fjalën e rastit e mbajti nënkryetari i shoqatës z. Agim Matraku. Përshëndetën dhe veteranë e të ftuar

si: Arben Tafaj, kryetar i shoqatës Tirana, i cili i dorëzoi djalit të inxhinier Daut Gurabardhit (pas vdekjes) titullin “Fisnikëria Tiranase”. Gjithashtu kryesia nderoi me Mirënjohjen e Shoqatës” veteranët: ish-pilotin dhe komandantin e Aviacionit Klement Aliko, inxhinier Xhevahir Shega e Daut Gurabardhi dhe shturmanin Luan Baraj. Në fund kokteji e foto të shumta mes veteranëve. Gjatë muajit maj shoqata do të organizojë në Vlorë ditë jubilarë kushtuar 60-vjetorit të krijimit të shkollës shqiptare të aviacionit (11 maj), ku dhe do të nderohen mjaft veteranë të kësaj shkolle në vite.



Baza Ajrore në Gjadër

Në emër të detyrës, të qiellit shqiptar...

Atë ditë zie
fund marsi, i
vetmuar, i ulur
diku poshtë krahut
të avionit, nisa të
shkruaj në
bllokun e
gabimeve që ne
pilotët
marrim
në fluturim.

**Pranvera që mori Luto Sadikun,
27 Mars 1982, vit dhimbjeje**

Të shkruash për fluturimin në dukje është e lehtë, por kur fillon ngatërroshesh në fjalë dhe fjali, ato vijnë vrellshëm dhe po kaq shpejt fluturojnë në hapësirën e pafund të mendimeve.

Atë ditë zie fund marsi, i vetmuar, i ulur diku poshtë krahut të avionit, nisa të shkruaj në bllokun e gabimeve që ne pilotët marrim në fluturim. Ky shkrim është bruto, ashtu me gabime i rënduar nga dhimbja, i rënduar nga ajo situatë dëshpërimi shokësh.

Baza Ajrore në Gjadër, shkrimin që nuk e botova.....

Në këto vite fluturimi, ne të qiellit përgatitemi, stërmundohemi, sakrifikojmë dhe krenarë do të vazhdojmë të fluturojmë për një ideal të vetëm, të formuar, të ngjizur në qenien tonë: për Hapësirën mbi kokat tona, për qiellin që strehon Shqiptarinë, të kudondodhur.

Një vit më parë, në aerodromin e Gjadrit, e prisja me pasion fluturimin e

parë vetëm, por dhe pranverën që sapo kishte nxjerrë lajmëtarët e parë duke sfiduar dimrin që vështirësisht asaj po i linte vendin. Ne e kërkonim atë, pranverën si banorë të vetmuar të një hoteli beqarësh në buzë të lumit Gjadër, afër pistës të kufizuar me vija të bardha dhe të nxirë nga rrotat e avionit dhe të turbinës zhurmuese të motorit të tij.

Në fund të muajit mars erdhi dita e fluturimit të parë vetëm. Ditë e madhe: Fluturimi me avionin që sfidon zërin. Në pritjen e gjatë, të etur për fluturimin po ngatërrohim radhën. Fluturimi solli Pranverën apo pranvera e solli atë.

Kishte ardhur pranvera dhe kishte çelur bari në dy anët e pistës që na lehtësonte lodhjen e syve në ato ditë të ngarkuara stërvitjeje. Ajo na solli edhe ato pak lule që i kishim aty pranë vendçlodhjes tonë që rrinim ditë-natë me kokën gjithmonë në survejim të qiellit.

Me përkujdesjen tonë ato pak lule hijeshonin mjedisin rreth e qark që dominohej nga ndriçimi i duraluminit të trupit



të avionëve dhe nga kabinat e zbukuruara me shumë butona e çelësa të kuq me emrin "rrezik". Të rreshtuar si ushtarë të disiplinuar në komandën 'Gati-tu', avionët dominojnë tërë hapësirën e bazës.

Ne jetojmë me ta ditë-natë, të lidhur me zinxhirët e kostumit të fluturimit. Çudi, në këtë ndërtesë njëkatëshe, modeste, ngrysim të mbyllur gjysmën e muajit dhe përsëri ndjehemi mirë, të motivuar që në krahë të saj rrinë të heshtur avionët gati për ngritje, që edhe minuta është shumë për të zhurmuar qiellin. Ndodh kështu për ditë...

Avionët zhurmojnë njeri pas tjetrit duke marrë rrugën e qiellit që kësaj toke mos t'i mungojë kurrë pranvera. Marrin lartësi në qiell duke ndryshuar gradualisht formën e tyre dhe humbasin në hapësirat e pafund. Ja diku, tamam si ajo pika e zezë që le maja e lapsit në një faqe të bardhë, duken ata lart shumë larg. Brenda tyre janë ata, të ngritur nga kjo pistë fluturimesh, janë shokët e mi të dashuruar përjetësisht me qiellin dhe fluturimin.

Në ngrihem në ajër, të vetmuar, të ngarkuar me një arsenal të fuqishëm armatimi për të ruajtur qiellin e pastër, që bari dhe lulet të lulëzojnë për herë.

Mars 1982, pranverë... Ah, sa shpejt, pa filluar mirë ajo, pa u larguar ditët e ftohta, kjo pistë e zhurmshme ndaloj frymë-marrjen. Diçka e tmerrshme, e pabesueshme, ishte rezervuar këtë ditë marsi për shokun tonë që sa ishte ngritur në fluturim.

Një shpend fluturues ishte futur në helikën e motorit të avionit dhe... Flaka dhe shpërthimi i papritur tronditi gjithçka. Brenda kabinës së avionit që digjej në ajër rrihte për herë të fundit zemra e shokut tonë, njërit prej pilotëve më të mirë të krejt avacionit luftarak shqiptar. Pista u vesh me dhimbjen, me veladonin e zi nga gjaku i shokut tonë diku në fund të saj.

Të gjithë ulëm kokën drejt tokës duke e akuzuar atë por edhe qiellin përse na more

shokun tonë, më të mirin shok? Perse?

Ecëm në aerodromin e zi me kokën të ulur. Në heshtje! Ecëm në heshtje me peshën e dhimbjes në shpirt, por për pak kohë, sepse shpejt qielli na thirri përsëri, na magnetizoi, ashtu si vetë ai me pafundësinë e tij të fton dhe sytë tanë u drejtuan drejt tij, ai na priste ta zhurmonim, për të ardhmen, për shokun tonë, për ato lule që vendosëm mbi të, të mos vyshken kurrë...

Në kaltërsinë e qiellit, me krahët fluturues ne vozitëm mbi male, fusha dhe dete. Në to ne gjetëm moralin, forcën, guximin duke kapërcyer fund-pistën e përgjakur, morëm lartësinë duke kërkuar diku në qiell edhe shokun në çdo fluturim, edhe shokët tanë, ata janë shumë...

Tek kjo fund-pistë e zezë, aty, nuk ishte më ai që na mësoi dhe na drejtoi fluturimin si shokë, larg hierarkisë së drejtues, por pilot, i talentuari i ajrit, Luto Sadiku. Ai ishte i të gjithëve.

Ai iku duke na lënë një mal me kujtime, u ngrit përjetshëm në qiell, u preh përgjithmonë midis tokës dhe qiellit.

...Dje u përshëndeta me vajzat e tij, ai fliste shpesh për to. Ndjeva dhimbje, 'babi, babi...', ai nuk është më, ai nuk jeton më për vajzat, për familjen, për ne..., por vetëm fizikisht, pasi kujtimet po, ato janë me ne, ato janë pafund. Shumë mendime më erdhën në kokë, u mundova t'i largoj, por ato më vinin prapë, më ngatërronin, unë i shtyja me forcë..., nëse..., nesër..., unë...mos...

Nuk u vonuam, nuk e ulëm kokën, gjetëm forcën për detyrën, vijua traditën, shpejt fluturoam, por rruga e pilotit është e vështirë, ne e dimë që ai qiell dhe ky avion kërkon sakrificë, edhe pse ndoshta..., por zemra jonë është e fortë, shpirti i pilotit është luftarak, ne nuk frikësohemi.

Ne nuk u dorëzuam, u ngritëm në ajër duke realizuar detyrat në perfeksion, më mirë sa ata përtej kufijve tanë, që na shoqërojnë me grykat e topave kundërajrore

diku në këmbë të Taraboshit. Pilotët heronj ne i vendosim në piedestalin e qiellit, duke i menduar ata diku në qiell në një fluturim të përjetshëm. Ata janë yje atje lart.

Ah..., ne realizojmë ëndrrën duke pranuar edhe vdekjen, piloti luan tërë jetën me vdekjen në emër të një dashurie të madhe, të qiellit mbi atdheun e tij. Shumë shokë qiellin e kthyen vendin e tyre të përjetshëm, ne i kemi ngjizur emrin e tyre diku lart, i përjetësuam si një yll që ndriçon në qiellin e dashurisë sublime për atdheun, ndaj ne u ngritëm përsëri në ajër për t'i ndriçuar edhe ata me forcën e fluturimit tonë. Qielli na kërkon të jemi vigjilentë, të përgatitur pse jo edhe për të dhënë jetën. Ne nuk ia kursejmë atij, shokët e mi ia dhanë, ata janë shumë, pilotët të rënë në krye të detyrës janë shumë. Dhimbje! Por jemi krenarë që atdheu na ka përzgjedhur dhe besuar një arsenal të fuqishëm armatimi me bomba, raketa dhe topa qa ta ruajmë atë. Ne jemi gati të ngrihem në ajër, të sakrifikojmë jetën kur Atdheu të na kërkojë. Ne jemi gati të shkruajmë emrin tonë në ajër! Ne jemi gati të bëhemi heronj të qiellit dhe të tokës, për vendin tonë për Shqipërinë tonë!

...

Në këto shënime të asaj kohe janë hedhur dridhje zemre pilotësh në rreziqe, aq sa të trishta po dhe aq heroizma fluturimesh të ndodhur në atë grusht hekurash, përbindësh, përballë egërsisë të së papriturës, fluturim, të natyrës dhe teknologjisë të pabesë. Në to gjen akoma mallin e pafund që djeg, në to gjen akoma rrahje zemrash të familjeve të pilotëve, ndjen stërmundimin e tyre për t'i përballuar ato dhe për të ecur përpara. Dhimbje prindërisht, bashkëshortesh, fëmijësh dhe dhimbje shokësh, vëllezërisht. Ato nuk të lënë rehat, kujtime për të gjithë ata që kanë marrë rrugën e qiellit. Ah, na kanë mbetur shumë shokë në qiellin e pafund që mbulon Shqipërinë!

Drama e një lufte dhe "kthetirat e ferrit" që po përpijnë njerëzimin

Pas pushtimit rus të Ukrainës, fëmijët atje po përjetojnë pasojat shkatërruese të të jetuarit në një zonë lufte - kërcënimin e vazhdueshëm të granatimeve, të shtënave dhe humbjes së njerëzve të dashur, si dhe shqetësimin për aksesin në ushqim, ujë të pijshëm të pastër dhe kujdes shëndetësor.

Punoi: Shefe e Sektorit të Botimeve,
ANJEZA MUSOLLARI

Kanë frikë se vriten, nënat ukrainase u shënojnë fëmijëve të dhënat në trup

Lajm që mbushi faqet e çdo medie vizive apo të shkruar. Lajme rrëqethëse që nuk dimë ende sa do të zgjasin? Kthejmë sytë nga qielli të gjithë ne, që besojmë tek një forcë hyjnore, sepse "tokësorët" i ka verbuar pangopësia, (karakteristikë e epokës së hershme nga vijmë).

Sa e brishtë historia?

Si në një celuloid të shfaqen regjitet e filmave me arsenal armësh apo njerëz të tretur në eter, rrugë të lara nga gjurmë gjaku, lodra fëmijësh, mbetur në cepa pallatesh pa adhuruesit e tyre.

Kjo është një epoke e re?!

Në vlera numrash kemi ecur në rend rritës, por a ndryshon historia e

kohëve moderne nga ajo e shekujve të mëparshëm?

Thjesht kemi përsëritur veten në dimensione edhe më shtazarake. "Luftë mes llojit"

Pas pushtimit rus të Ukrainës, fëmijët atje po përjetojnë pasojat shkatërruese të të jetuarit në një zonë lufte - kërcënimin e vazhdueshëm të granatimeve, të shtënave dhe humbjes së njerëzve të dashur, si dhe shqetësimin për aksesin në ushqim, ujë të pijshëm të pastër dhe kujdes shëndetësor.

"Holokausti" në kurrizin e njomë të fëmijëve ukrainas?

Shkruar emri, mbiemri, data e lindjes, sepse e nesërmja nuk dihet se çfarë sjell për fatin e tij. Sepse e drejta e fëmijëve për të jetuar dhe që juridiki-kisht përfaqësuesit e gjithë shteteve kanë firmosur mbi Konventën e të Drejtave të Fëmijëve për një botë të paqte dhe të bukur po shkel fuqishëm me këmbë çdo parim të firmosur me dorë.



“Trashëgimia e kësaj lufte do të jetë një brez i traumatizuar”

Nëpërmjet një statusi në rrjetet sociale, Ambasada Amerikane njofton se nga lufta në Ukrainë janë vrarë 183 fëmijë dhe 342 të tjerë janë plagosur. “Pas çdo vdekjeje të një fëmije, nëna, babai apo familja ndryshon përgjithmonë. Çdo atentat u krye nga një ushtar, komandant rus dhe Vladimir Putin, krimet e të cilit nuk do të harrohen. Lufta është ndezur, askush nuk e di se cila ishte drita e fundit e hënës dhe ende njerëzit nuk bërtisnin nën shpërthimin e predhave: “Stop! Jo!”. Lufta po vazhdon dhe tanket do të lëvizin dhe njerëzit...”

Lufta është gjëja më e keqe që mund të ndodhë në jetën e çdo njeriu. Ajo mbart shumë frikë, dhimbje, britma, klithmat e nënave, fëmijëve, bashkëshorteve, humbje të njerëzve të dashur...

Sa fëmijë la jetimë, dhe të veja me shami të zeza në kokë. Sa kujtime të tmerrshme ajo la pas në kujtesën njerëzore.

Pas?! Apo aty ka qenë gjithmonë?

Lufta është dhimbja e fateve njerëzore, e shkaktuar nga ata që sundojnë në krye dhe e dëshirojnë pushtetin në çdo mënyrë, qoftë edhe të përgjakshme.

Lufta e Madhe Patriotike me të drejtë mund të quhet e shenjtë. Në fund të fundit, të gjithë njerëzit u ngritën për të mbrojtur atdheun e tyre, ashtu si populli ukrainas sot po mbron atdheun e tij, duke mos pasur frikë nga një plumb endacak, mundim, robëri dhe shumë më tepër. Paraardhësit tanë u mbledhën aq shumë dhe shkuan përpara për të rimarrë vendin e tyre nga armiku, në të cilin ata lindën dhe u rritën. Për brezin e ri Lufta e Madhe Patriotike është vetëm një histori nga e kaluara e largët. Por kjo histori trazon gjithçka brenda dhe të bën të mendosh për atë që po ndodh në botën moderne. Mendoni për luftërat që shohim tani. Mendoni se nuk duhet të lejojmë një luftë tjetër dhe t’u vërtetojmë

ushtarëve heroikë se jo më kot po bien për atë tokë, se jo më kot u lag dheu me gjakun e tyre! Unë dua që të gjithë të kujtojnë koston e kësaj Fitoreje jo të lehtë dhe pagën që duket se po cenohet mbi kokën tonë!

Dhe atëherë nuk do kemi më nevojë për laps dhe letër se bi-

ndryshëm. Në klasë, për shembull, ke një fëmijë me ngjyrë të ndryshme lëkure, por e ke shok. Ke një tjetër që flet ndryshe, nuk e kupton, por e ke shok. Mund t’i tregosh botës se të merresh vesh me tjetrin nuk do të thotë të kesh të njëjtën ide me të. Mund të ndodhë që njëri nga shokët ka



lancet njerëzore do i bëjmë me gishtat e njërës dorë.

S’mjafton një ditë për të kujtuar, duhet dhe e nesërmja...

I dashur vogëlush, ti mund të bësh shumë që lufta të përfundojë dhe paqja të kthehet. Ti mund t’i tregosh botës se është e mundur të jemi miq, pavarësisht se të

ide të tjera e grindesh me të, por, pastaj, bëni paqe menjëherë. Mund të bësh paqe duke i thënë shokut të mos zemërohet, se përndryshe do të trishtoheni të dy. Kur bëjmë paqe, jemi të lumtur! Mund edhe të ndërhysh kur një shok grindet me dikë e ta bësh të qeshë, duke e bërë fytyrën qesharake, ose duke i thënë një fjalë gazmore.

Studentët e FA-së vizitojnë “West Point”

INTERVISTOI
ANJEZA MUSOLLARI

Bazuar në programin arsimor si në të gjitha Akademitë Ushtarake, secila sjell përfitimet e veta, por qëllimi është i njëjtë dhe ne si akademi po mundohemi që t'i përfrohemi modelit të “West Point”.

Arritja e përsosmërisë në sistemin arsimor është mjeti më i rëndësishëm i suksesit tonë të ardhshëm.

Të zgjedhësh një model arsimimi nuk është vetëm mundësi, por dhe përgjegjësi. Vlera e një modeli është në proporcion të drejtë me faktin se sa mirë korrespondon me të shkuarën, të tashmen, të ardhmen, nivelin aktual apo potencial të mundësive dhe prespektivës. Ndaj Qeveria Shqiptare, Ministria e Mbrotjtjes dhe FA po implementojnë në sistemin tonë arsimor ushtarak, sistemin e Akademisë Ushtarake të “West Point”, ku vizitorë të këtyre ditëve fillim pranvere ishin dhe studentët tanë të FA-së. Për të ndarë eksperiencën e tyre me lexuesin e gazetës “Ushtria” të rinjtë tanë sot, por ushtarakët e karrierës nesër, studentet Hanke Pasha dhe Qefli Toleni do të sjellin emocionet e tyre të para.

Si pjesë e studentëve të FA-së, patët fatin të vizitonit një prej universiteteve ushtarake me histori dhe

standard të pa konkurrueshëm, siç është “West Point”. Si u gjendët atje?

Për programin e shkëmbimit të studentëve mes dy akademive u përzgjedhëm nga drejtuesit që ne të përfaqësonim AFA-në, pasi fillimisht në muajin mars patëm një vizitë nga dy studentë amerikanë të Akademisë së “West Point”.

Si ishte mikpritja ndaj studentëve shqiptarë?

Pritja ishte mjaft e mirë, pasi na bënë të ndiheshim komod atje, duke na mbështetur dhe duke na bërë pjesë të tyre. Pati një angazhim të madh edhe nga pjesa tjetër e studentëve, kjo na la ne përshtypjet më të mira.

Sipas mendimit tuaj, cilat janë përfitimet kryesore për një student që studion në “West Point” dhe një studenti në FASH?

Bazuar në programin arsimor si në të gjitha Akademitë Ushtarake, secila sjell përfitimet e veta, por qëllimi është i njëjtë dhe ne si akademi po mundohemi



që t'i përafrohemi modelit të "West Point". Përfitimi kryesor në të dy rastet është mundësia që na jepet për t'u përgatitur për t'i shërbyer vendit si oficer i Forcave të Armatosura. Një e përbashkët që përfitojnë studentët është paga gjatë studimeve dhe punësimi i siguruar menjëherë pas përfundimit të tyre.

Si është një ditë, për një student në shkollën tuaj dhe si ishte një ditë në "West Point"?

Pamë që programi mësimor ishte më i komplikuar krahasuar me atë që kemi ne, pasi kanë më shumë degë të ndryshme studimi si dhe janë më të angazhuar me aktivitetet fizike. Krahasuar me aktivitetin tonë ditor ata ishin më të ngarkuar, konkretisht në pjesën e parë të ditës, ku studentët ishin të gjithë nëpër klasa sipas degëve të tyre të studimit. Në mbarim të mësimit studentët angazhoheshin me aktivitete fizike, mbledhje apo aktivitete të tjera të ndryshme kulturore, argëtuese, edukative, të organizuara nga vetë studentët.

Cilat janë gjërat më domethënëse që ju do të donit t'i kishit si pjesën tuaj këtu?

Ajo çfarë na bëri përshtypje më tepër, sa i përket anës ushtarake, ishte hierarkia e komandimit, ku studentët e viteve të ndryshme komandonin njeri-tjetrin por ndryshe nga ne, ata ishin të përzier edhe në nivelet e komandimit me qëllim që çdo student të ketë në vartësi studentë të vitit më të ulët për t'i mësuar më mirë mënyrat e komandimit. Programi ishte një tjetër pikë e fortë e tyre, pasi zbatohet me përpikëri dhe kishte një larmi aktivitete që kryheshin gjatë ditës.

Si e shihni të ardhmen në raport me bashkëmoshatarët tuaj që studiojnë atje?

Pas përfundimit të Akademisë, si ata, ashtu edhe ne diplomohemi oficerë me gradën N/toger dhe fillon karriera ushtarake, por ndryshimi është se ne dalim oficerë të përgjithshëm ndërsa secili student i "West Point" përgatitet gjatë katër viteve në specialitetin e përzgjedhur, kjo edhe për shkak të numrit të madh të specialiteteve

në ushtrinë amerikane. Ne e marrim specialitetin me përfundimin e studimeve dhe më pas kryejmë kualifikimin e nevojshëm për këtë specialitet.

Cilat janë të përbashkëtat dhe të veçantat e dy universiteteve?

E përbashkëta mes dy akademive është qëllimi i njëjtë, dhe ndryshimi është që programi studimor në "West Point" është katërvjeçar ndërsa këtu është trevjeçar, numri i studentëve është shumë më i madh, krahasuar me ne, pasi këtu vjet është rihapur akademia, si dhe logjistika atje është më e pasur krahasuar me atë këtu.



Cilat janë disa prej rregullave më të forta që gjetët në "West Point", duke ditur që ai universitet ka rregulla hermetike? Si u ndjetë përballë tyre?

Një ndër rregullat që pamë ndryshe nga akademia jonë është që studentit në momentin që ngel në një lëndë është i penalizuar për

të përsëritur të gjithë semestrin, ndryshe nga këtu që jepet një mundësi e dytë për t'u rritur vetëm në lëndën mbetëse në përfundim të vitit përkatës. Në këtë rast ne ndihemi pak më të privilegjuar dhe të toleruar në këtë drejtim, por nga ana tjetër mendojmë se kjo mase do t'i shërbente vetë studentit për t'u përkushtuar më shumë në kalimin e sprovave e provimeve me herën e parë.

-Zhvillimi i udhëheqësve të ardhshëm ushtarakë e politikë i ka rrënjët në parimet e një përgatitjeje etike dhe morale si dhe në Kodin e Nderit, sipas të cilit kadetët betohen se, "Nuk do të gënjejnë, nuk do të mashtrojnë, nuk do të vjedhin dhe nuk do të tolerojnë as ata persona që bëjnë gjëra të tilla". Secili kadet sot, është një udhëheqës nesër, thuhet në portalin e Akademisë "West Point", dhe si të tillë janë shembuj për të tjerët.

Çfarë do të thotë kjo për ju sot? Sa i rëndësishëm është ky "postulat" për njerëzit nën uniformën ushtarake, pjesë e së cilës do të jeni ju nesër?

Ky është parimi i çdo studenti ushtarak që nga dita që bëhet pjesë e Akademisë dhe derisa kalitet për t'u bërë oficer. Rëndësi ka jo vetëm të mos gënjejnë, mashtrojnë apo vjedhin vetë, por të mos tolerojnë as kolegët e të tjerët nëse i bëjnë këto. Kjo ndikon direkt në formimin e integritetit moral të secilit student dhe për më tepër edhe në formimin e karakterit të tij, që do ta shoqërojë gjatë gjithë jetës së tij në uniformë dhe jashtë saj.

Sollët për shokët tuaj një eksperiencë unike, e cila ju hapi një dritare të re, për atë se çfarë kërkonin dhe se çfarë po ju ofrohet. Së shpejti, me këmbënguljen e ministrit Peleshi dhe angazhimin maksimal të FA-së, ju do të keni ambiente universitare dhe akademike të njëjta me atë të sjellë nga përtej oqeanit. Për këtë kërkohet dhe angazhimi juaj për të arritur nivelin e miqve tuaj të "West Point".

Suksese studentëve tanë në rrugëtimin e tyre të vështirë dhe dinjitoz!

Automjetet dhe lodrat kryesojnë listën e produkteve të rrezikshme jo ushqimore këtë vit

Komisioni European publikoi raportin e tij vjetor mbi "Safety Gate" (Porta e Sigurisë), sistemi i alarmit të shpejtë të BE-së për produktet e rrezikshme jo ushqimore. Raporti mbulon sinjalizimet e njoftuara gjatë vitit 2021 dhe veprimet e ndërmarra nga autoritetet kombëtare në përgjigje. Në këtë raport vjetor, për herë të parë, makinat janë në krye të listës së produkteve të njoftuara, e ndjekur nga lodrat. Gjithashtu, në kontekstin e pandemisë COVID-19, pajisjet mbrojtëse si maskat për fytyrën përbëjnë ende një pjesë të konsiderueshme të produkteve të njoftuara.

Në dritën e zhvendosjes së konsumit drejt platformave të blerjeve online, janë zhvilluar gjithashtu instrumente të reja për të mbrojtur më mirë konsumatorët që blejnë online dhe për të hequr produktet e rrezikshme nga tregu. Në përputhje me këto objektivë, Komisioni sot lançon gjithashtu një mjet të ri të mbikëqyrjes elektronike të quajtur "web crawler" që do të ndihmojë autoritetet kombëtare të zbulojnë ofertat në internet të produkteve të pasigurta të sinjalizuara në "Safety Gate".

Didier Reynders, Komisioner

ri për Drejtësinë, tha: "Safety Gate" është dëshmuar edhe një herë të jetë një mjet jetik për të mbajtur konsumatorët të sigurt nga produktet e rrezikshme. Unë jam gjithashtu krenar për përmirësimin dhe përforcimin e vazhdueshëm të sistemit. Është shumë e rëndësishme që "Safety Gate" të përgatitet për t'u përshtatur me mjedisin e ri të konsumatorit. Në këtë mënyrë, ne mund të sigurojmë që "Safety Gate" të mbetet një mjet efikas për Tregun Unik, duke mbrojtur konsumatorët në të gjitha rrethanat. Gjithashtu ka ndihmuar që pajisjet e përdorura në luftën kundër pandemisë të jenë të standardeve më të larta."

Gjetjet kryesore të raportit

Në vitin 2021, autoritetet e vendeve pjesëmarrëse të Rrjetit të Sigurisë shkëmbyen 2 142 sinjalizime përmes sistemit. Për herë të parë, numri më i lartë i sinjalizimeve u njoftua në kategorinë "mjetet motorike", e ndjekur nga "lodrat" dhe "aparartet dhe pajisjet elektrike". Për sa i përket mjeteve motorike, veprimet e ndërmarra kanë të bëjnë kryesisht me rikujtimet pas konstatimit të problemeve teknike, ndërsa për lodrat janë fokusuar tek prania e lëndëve kimike të rrezikshme, si dhe bateritë me butona. Për më tepër,

problemet më të zakonshme të raportuara për aparatet dhe pajisjet elektrike lidhen me ekspozimin e pjesëve të ndezura dhe çështjet e mbinxehjes.

Ndërsa pandemia vazhdon, veprimet e mbikëqyrjes shfaqën një sërë produktesh të lidhura me COVID-19. Kishte shumë alarme në lidhje me pajisjet mbrojtëse, veçanërisht maskat mbrojtëse ishin në qendër të vëmendjes. Pesë rreziqet më të zakonshme të raportuara ishin lëndimet personale, kimikatet, zjarri, mbytja dhe goditjet elektrike. Në total, 4 965 njoftime vijuese qarkulluan në "Safety Gate", duke treguar se Shtetet Anëtare monitorojnë nga afër alarmet dhe shpesh ndjekin masat shtesë të marra në vendet e tyre.

Raporti tregon se në vitin 2021, përdorimi i përgjithshëm i rrjetit të sistemit të alarmit të shpejtë u rrit midis 30 vendeve pjesëmarrëse (BE27 plus Islanda, Lihtenshtajni dhe Norvegjia), duke i mbajtur konsumatorët të sigurt nga produktet e rrezikshme.

Hapat e ardhshëm

Komisioni po lançon një mjet të ri të mbikëqyrjes elektronike të quajtur "web crawler". Mjeti do të mbështesë autoritetet kombëtare në zbulimin e ofertave në internet të produkteve



të rrezikshme të sinjalizuara në "Safety Gate". Ky mjet do të identifikojë dhe do të renditë automatikisht secilën nga këto oferta, duke lejuar autoritetet e zbatimit të gjurmojnë ofruesin dhe të urdhërojnë tërheqjen efektive të këtyre ofertave. Kështu, ai do të ndihmojë në harmonizimin e qasjes aktuale të fragmentuar dhe adresimin e sfidave të monitorimit të shitjeve online të produkteve të rrezikshme.

Më 30 qershor 2021, Komisioni paraqiti gjithashtu një propozim për një Rregullore të re të Përgjithshme të Sigurisë së Produkteve që zëvendëson Direktivën aktuale të Sigurisë së Përgjithshme të Produkteve. Rregullorja synon të modernizojë kuadrin e përgjithshëm për sigurinë e produkteve të konsumit jo ushqimor për të ruajtur rolin e tij si një rrjet sigurie për konsumatorët dhe për të përmbushur sfidat e sigurisë së produkteve të paraqitura nga produktet e reja të lidhura me teknologjinë dhe nga rritja e shitjeve në internet.

Në nivel ndërkombëtar, duke pasur parasysh marrëdhëniet e forta tregtare BE-SHBA dhe ng-

jashmëritë midis dy tregjeve, Komisioni European po fillon një dialog jozyrtar për mbrojtjen e konsumatorit me Komisionin e Sigurisë së Produkteve të Konsumatorit të Shteteve të Bashkuara për të forcuar më tej bashkëpunimin. Ky dialog do të mbulojë rritjen e tregtisë elektronike, zgjerimin e teknologjive të reja, globalizimin e prodhimit dhe shitjeve me pakicë, si dhe nevojat specifike të grupeve vulnerabël të konsumatorëve. Kjo pason një dialog të parë jozyrtar mbi mbrojtjen e konsumatorit të mbajtur në mars nga komisioneri Reynders dhe kryetarja e Komisionit Federal të Tregtisë së Shteteve të Bashkuara, Lina Kahn. Që nga viti 2003, "Safety Gate" mundëson shkëmbimin e shpejtë të informacionit midis shteteve anëtare të BE-së/ZEE-së, MB (Irlanda e Veriut) dhe Komisionit European në lidhje me produktet e rrezikshme jo ushqimore që paraqesin rrezik për shëndetin dhe sigurinë e konsumatorëve. Mund të ndërmerren veprimet e duhura përcjellëse dhe produktet mund të hiqen nga tregu. Komisioni

menaxhon faqen publike të internetit "Safety Gate", e cila ka një ndërfaqe moderne dhe miqësore për përdoruesit për të lehtësuar procesin e njoftimit. Faqet janë përkthyer në të gjitha gjuhët e BE-së (përfshirë gjuhën gale që nga viti 2022), islandeze dhe norvegjeze. Bizneset mund të përdorin gjithashtu "Business Gateway" për të informuar autoritetet kombëtare shpejt dhe me efikasitet në lidhje me shqetësimet e sigurisë në lidhje me një produkt që ata kanë hedhur në treg.

Një veprim tjetër për mbrojtjen e konsumatorit është Premtimi i Sigurisë së Produkteve, i cili përcakton veprime specifike vullnetare të tregjeve për të hequr ofertat e produkteve të pasigurta nga platformat e tyre. Deri më sot, njëmbëdhjetë tregje online kanë nënshkruar këtë marrëveshje për të bashkëpunuar me Shtetet Anëtare për të hequr produktet e rrezikshme nga faqet e tyre të internetit: bol.com, eMAG, Wish.com, AliExpress, Amazon, eBay, Rakuten France, Allegro, Cdiscount, Etsy dhe Joom.

Fuqizimi i avantazhit teknologjik të NATO-s

MSC. MIMOZA GOLIKJA

Më 13 prill 2020, NATO njoftoi se pavarësisht ndikimit të pandemisë, Organizata e Shkencës dhe Teknologjisë e NATO-s (STO) ofroi me këmbëngulje Programe të shkëlqyera të Punës (PoWs) falë rrjetit të saj prej mbi 5 000 shkencëtarësh, inxhinierësh dhe analistësh. Kjo siguron që STO të mbetet në pararojë të S&T dhe është e përkushtuar për të mbështetur avantazhin teknologjik të NATO-s, Aleatëve dhe Partnerëve në një botë gjithnjë e më konkurruese.

STO ka shpërndarë publikisht tre raporte për vitin 2022, që nxjerrin në pah arritjet e saj depërtuese dhe përshkruajnë rrugën për të ardhmen.

"Refleksionet e STO 2021", është njëri prej tyre, që ilustron ndikimin dhe rëndësinë e POW-ve të STO-së për Aleancën, duke mbuluar Qendrën për Kërkime dhe Eksperimentim Detar (CMRE) PoW dhe Bashkëpunues PoW (CPoW). Kjo përfshin mbi 300 aktivitete që variojnë nga programet kryesore kërkimore deri të skanimit të horizontit dhe seritë e leksioneve, si dhe demonstrimi bashkëpunues i teknologjive.

Raporti synon të jetë si një përmbledhje e projekteve dhe arritjeve të përfunduara së fundmi si në CMRE ashtu edhe në PoW 2021. Ai gjithashtu përmbledh këshillat e prodhuara për udhëheqjen e NATO-s për të ndihmuar vendimmarrjen e nivelit të lartë për tema vendim-



tare si "Gratë në Forcat e Armatosura", "Kërcënimet dhe rreziqet CBRN", "Teknologjitë në zhvillim dhe shkatërruese (EDT)", "Ndryshimet klimatike dhe tendencat S&T 2020-2040". Misioni i CMRE është të organizojë dhe kryejë kërkime shkencore dhe zhvillim teknologjik, të përqendruar në fushën detare, duke ofruar zgjidhje novatore dhe të testuara në terren të Shkencës dhe Teknologjisë (S&T) për të adresuar nevojat e mbrojtjes dhe sigurisë së Aleancës.

Raporti Vjetor 2021 CMRE thekson nga ana e tij aktivitetet e CMRE-së në ekzekutimin e programit të saj të punës për vitin 2021 dhe arritjet në ofrimin e produkteve dhe shërbimeve me vlerë të shtuar për klientët e saj, dhe në veçanti për Komandën Aleate të NATO-s për Transformimin si pjesë e programit Detar S&T me fokus në kundërmasa autonome të minave detare; autonomi për luftën kundër nëndetësve; njohuritë e të dhënave mjedisore dhe efektiviteti operacional; dhe mundësuesit e sistemeve detare pa pilot. Raporti vjetor ilustron se

si shkencëtarët, inxhinierët dhe teknologët e CMRE shfrytëzojnë teknologjitë në zhvillim dhe përçarës në mënyra inovative për të ruajtur avantazhin teknologjik të NATO-s. Programi i Punës Bashkëpunuese 2022, është gjithashtu një program tjetër që ofron një përmbledhje të projekteve të Organizatës së Shkencës dhe Teknologjisë (STO) të planifikuara për vitin 2022 në kërkimin dhe zhvillimin teknologjik të mbrojtjes dhe sigurisë për aftësitë e zgjeruara ushtarake operationale për Kombet dhe NATO-n. "CPoW 2022" përbëhet nga 283 aktivitete kërkimore teknike të vazhdueshme dhe të planifikuara dhe 49 ekipe eksploruese.

CPoW është një mjet i krijuar për t'iu përgjigjur nevojave të Kombeve dhe kërkesave të NATO-s. Prandaj, ndërtimi i tij bazohet në orientimin strategjik të ofruar nga Kombet, Panelet/Grupet gjatë takimeve të tyre të biznesit dhe organizata më e lartë e centralizuar e NATO-s. Në fund të fundit, Kombet, përmes Bordit të Shkencës dhe Teknologjisë

(STB), mbeten autoriteti kolektiv që vendos se si duhet të zhvillohet CPoW. Projektet kërkimore CPoW, të menaxhuara nga Zyra e Mbështetjes së Bashkëpunimit STO (CSO) në Paris, Francë, do të kryhen në të gjitha fushat aktuale të CpoW: Teknologjia e Aplikuar e Automjeteve (AVT); Faktorët Njerëzorë dhe Mjekësia (HFM); Teknologjia e Sistemeve të Informacionit (IST); Analiza dhe Studimet e Sistemit (SAS); Konceptet dhe Integrimi i Sistemeve (SCI); Sensorët dhe Teknologjia Elektronike (SET); si dhe Modelimi dhe Simulimi (NMSG). Nga ana tjetër për vitin 2022, shumë projekte CPoW vazhdojnë të përqendrohen në aplikimet dhe implikimet e Teknologjive në zhvillim dhe përçarjeje të NATO-s, si inteligjencë artificiale, autonomi, të dhëna të mëdha, bioteknologji, hipersonikë, shkenca kuantike, hapësirë dhe materiale të reja.

Rreth Organizatës së NATO-s për Shkencë dhe Teknologji (STO)

Organizata e NATO-s për Shkencë dhe Teknologji (STO) ofron inovacione, këshilla dhe zgjidhje shkencore për të përmbyshur nevojat gjithnjë në ndryshim të Aleancës. Ajo siguron që NATO të ruajë avantazhin e saj ushtarak dhe teknologjik për t'u përballur me sfidat aktuale dhe të ardhshme të sigurisë. STO është forumi më i madh kërkimor bashkëpunues në botë në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Ai mbështet qëndrimin e mbrojtjes dhe sigurisë së Aleancës dhe partnerëve të saj nëpërmjet kërkimit shkencor dhe teknologjik. Ka një komunitet prej më shumë se 6 000 shkencëtarësh të angazhuar në mënyrë aktive. Rrjeti STO bazohet në ekspertizën e më shumë se 200 000 njerëzve në vendet aleate dhe partnere. Programi i tij vjetor i punës përfshin mbi 300 projekte që mbulojnë një gamë të gjerë fushash si sistemet autonome, lufta kundër nëndetësëve, automjetet hipersonike, radarët

kuantikë dhe ndikimi i mediave sociale në operacionet ushtarake.

Me detyra të qarta dhe përgjegjësitë e saj kryesore, STO gjeneron dhe shfrytëzon një program pune të avancuar të shkencës dhe teknologjisë, duke dhënë rezultate dhe këshilla në kohë që avancojnë aftësitë mbrojtëse të aleatëve, partnerëve dhe NATO-s në mbështetje të detyrave thelbësore të mbrojtjes kolektive, menaxhimit të krizave dhe sigurisë bashkëpunuese. Ai gjithashtu mbështet vendimet e marra në nivel kombëtar dhe të NATO-s duke ofruar këshilla për Këshillin e Atlantikut të Veriut dhe udhëheqjen kombëtare. Siç theksohet dhe më sipër STO e arrin misionin e saj nëpërmjet një numri prej më shumë se 6 000 shkencëtarësh të cilët janë të angazhuar në mënyrë aktive. Po ashtu ritheksojmë se rrjeti STO bazohet në ekspertizën e më shumë se 200 000 njerëzve në vendet aleate dhe partnere. Struktura e STO-së drejtohet nga Bordi i Shkencës dhe Teknologjisë i NATO-s (STB). Bordi administron komitetet shkencore dhe teknike të STO-së dhe tre organet e tij ekzekutive si Qendrën për Kërkimin dhe Eksperimentimin Detar (CMRE) në La Spezia, Itali; Zyrën e Mbështetjes së Bashkëpunimit në Paris, Francë; dhe Zyrën e Shefit të Shkencëtarëve në Shtabin e NATO-s në Bruksel, Belgjikë. Shkencëtari kryesor është kryetar i STB-së dhe këshilltar i lartë shkencor i Këshillit të Atlantikut të Veriut. Komitetet shkencore dhe teknike, të përbëra nga anëtarë nga organet kombëtare dhe të NATO-s, drejtojnë dhe ekzekutojnë aktivitetet bashkëpunuese të shkencës dhe teknologjisë së NATO-s. CMRE organizon dhe kryen kërkime shkencore dhe zhvillim teknologjik, të përqendruar në fushën detare, duke ofruar zgjidhje novatore për të adresuar nevojat e mbrojtjes dhe sigurisë së Aleancës. CMRE kryen gjithashtu kërkime shkencore dhe inxhinierike praktike për përfitimin e drejtpërdrejtë të NATO-s dhe klientëve të tillë si sub-

jektet kërkimore dhe industria. Qendra operon me dy anijet kërkimore të NATO-s që mundësojnë eksplorimin dhe zhvillimin e zgjidhjeve shkencore dhe teknologjike në det. Kjo lejon që kërkimi unik dhe i specializuar të kryhet në fushat kryesore me interes për NATO-n. Aftësia inxhinierike e CMRE mundëson shfrytëzimin e shpejtë të prototipave të konceptit për përdorim në prova dhe eksperimente ushtarake. Qendra ka gjithashtu një bazë njohurish shkencore dhe inxhinierike të përbërë nga një platformë shkencore dhe botime të dedikuara, për përdorim në të gjithë NATO-n. NATO thotë se për të mbrojtur lirinë dhe vlerat e përbashkëta të Aleancës, është me rëndësi kritike për vetë NATO-n dhe vendet partnere të saj të ruajnë avantazhin në mbrojtje dhe siguri. Zbulimi, zhvillimi dhe përdorimi i njohurive të avancuara dhe shkencës dhe teknologjisë më të avancuar janë thelbësore për ruajtjen e avantazhit teknologjik që u ka mundësuar forcave të Aleancës të kenë sukses në të gjithë spektrin e operacioneve gjatë dekadave të fundit.

STO u krijua nëpërmjet shkrirjes së Organizatës së Kërkimit dhe Teknologjisë dhe Qendrës së Kërkimit Nënutor të NATO-s. Këto organe u mbledhën pas një vendimi në Samitin e NATO-s të vitit 2010, në Lisbonë, për të reformuar strukturën e agjencisë së NATO-s. STO, së bashku me organizatat e tij paraardhëse, ka qenë instrumental në mundësimin e këtij suksesi, si brenda kombeve ashtu edhe për vetë NATO-n. Prandaj NATO thekson se duke ofruar një vend kritik për zhvillimin dhe shpërndarjen e njohurive, STO mbetet e përkushtuar ndaj parimit të saj themelor që është bashkimi i ekspertëve të çështjeve nga i gjithë spektri shkencor me përdoruesit përfundimtarë ushtarakë, në mënyrë që të informojë vendimmarrësit për sfidat dhe mundësitë në zhvillim dhe për të siguruar avantazhin teknologjik të Aleancës dhe partnerëve të saj.



Në Ditën Kombëtare të të Pagjeturve, që përkon me datën e Masakrës së Mejës, Osmani ka thënë se dita është përkujtim, pritje e ankth për familjarët dhe shtetin e Kosovës.

"Janë mbi 1600 të zhdukur me dhunë, thirrja jonë për drejtësi, e cila do të vihet në vend kur para saj do të dalin autorët e krimeve dhe do të zbardhet fati i secilit nga njerëzit tanë. Duam dhe do të insistojmë të dimë për fatin e tyre. Kjo ditë na bën ta kthejmë kokën pas jo vetëm për t'i kujtuar ata që nuk janë në mesin tonë, por edhe për ta thënë fuqishëm se për ta nuk është vetëm një ditë si kjo, por çdo ditë. Me kujtimin për ta, do të bëjmë çdo ditë përpjekje që pritja e familjeve të marrë fund", -ka theksuar Osmani, sipas një komunikate nga Presidencia.

"Synimi i regjimit gjeno-cidial serb ishte spastrimi etnik, ndaj aksioni kriminal u shtri në 15 fshatra të Rekës së Keqe dhe Luginës së Çar-ragojës në Gjakovë. Meja është dhimbje e madhe e Kosovës dhe ndër rrëfimet më të përgjashme të luftës. Nuk do ta harrojmë kurrë, sepse vetëm kështoj do ta dimë vlerën e lirisë dhe shtetit. Do t'i kujtojmë përherë martirët e Mejës,



Osmani: Të zhdukurit me dhunë janë thirrja jonë për drejtësi

duke u angazhuar vazhdimisht që autorët të vihen para drejtësisë", -ka thënë Osmani në përkujtimin e Masakrës së Mejës.

Para 23-vjetësh, më 27 prill 1999, forcat serbe rrethuan Rekën e Keqe dhe Luginën e Çar-ragojës në rrethinën e Gjakovës. Në një operacion të planifikuar, u ndërpre në të gjitha rrugët duke lënë të hapura vetëm dy në drejtim të Mejës. Grumbullimi i meshkujve në grupe filloi në mëngjes, në një bilanc të

tmerrshëm që goditi 15 fshatra të rrethit të Gjakovës. U ekzekutuan 376 persona, në një prej masakrave më të mëdha në Kosovë. Të vrarë në këtë masakër mbetën djemtë e burrat në grupe nga mosha 15-60 vjeç. Atë ditë asnjëri nga të ndalurit nuk arriti të dilte i gjallë nga Meja dhe pas luftës disa prej trupave të masakruar të tyre u gjetën nëpër varreza masive nëpër Kosovë kurse të tjerët ka informacion se janë ende diku nëpër Serbi.



Ndërsa fokusi i luftës së Rusisë në Ukrainë po zhvendoset në lindje, forcat ruse po mbushin terrenin me mina tokësore.

Gjashtë gra ukrainase kanë filluar trajnimin në Kosovë për të çaktivizuar mjetet shpërthyes në vendin e tyre të shkatërruar nga lufta. Ato janë grupi i parë i çminuesve ukrainase që po stërviten nga qendra MAT Kosova, në qytetin e Pejës.

Instruktorët po u mësojnë gjashtë grave ukrainase se si të asgjësojnë municionet e pashpërthyer, të tilla si bombat thërrmu-ese, fushat e minuara dhe mbetje të tjera shpërthyes. 20-vjeçarja Anastasiia Minchukova thotë se iu bashkua trajnimit për të ndihmuar vendin e saj.

“Në Ukrainë ka një kërkesë të madhe për njerëz që dinë të bëjnë çminimin, sepse lufta do të përfundojë së shpejti. Ne besojmë se ka shumë punë për të bërë dhe them se do të jem e dobishme të ndihmoj”.

Anastasiia thotë se i mungon jeta normale që kishte jo shumë kohë më parë.

“Çfarë më mungon? Paqja.

Endërroj për paqen, për të fjetur në shtratin tim pa u shqetësuar se do të shkoj në

Gratë Ukrainase stërviten në Kosovë për të çaktivizuar minat

strehimore për bomba gjatë gjithë kohës. Më mungojnë njerëzit që humba. Po, jeta normale tek e cila nuk do të mund të kthehem më kurrë”.

Në Kosovë pati mjete të shumta të pashpërthyer të mbetura pas luftës në vitin 1999, derisa OKB-ja e shpalli të sigurt nga minat në vitin 2001. Suksesi i shpejtë në pastrimin e minave ka ndihmuar në krijimin e reputacionit të Kosovës si një vend i mirë për trajnime. Instruktori Artur Tigani i ka ende të freskëta plagët e luftës.

“Lufta është ende e freskët në kujtimet tona, edhe pse kanë kaluar gati 23 vjet. Janë ende të freskëta në kujtimet tona, vështirësitë që ndeshëm kur filluam pastrimin e minave në Kosovë. Kështu që qendra e trajnimit është ndërtuar mbi përvojën tonë të drejtpërdrejtë”.

38 vjeçarja Yuliia Katelik është

nënë e tre fëmijëve nga Kramatorsku:

“Si nënë e kuptoj që ka një problem me minat që është mjaft serioz sidomos për fëmijët. Ne përballemi me një përqendrim të lartë të përhapjes së llojeve të ndryshme të mjeteve shpërthyes dhe duhet të punojmë për sigurinë dhe mirëqenien e fëmijëve dhe të të gjithë njerëzve”.

Ekspertët thonë se trupat ruse kanë shpërndarë mina të shumta pas tërheqjes së tyre nga veriu i Ukrainës tani që po përqendrohen në lindje, duke përfshirë variante me sensorë të ndjeshëm që mund të shpërthejnë nëse dikush u afrohet, edhe pa i prekur. Fakti që shumë prej tyre janë vendosur pa dallim rreth zonave të populluara është dëshmi, thonë vëzhguesit, e qëllimit të Moskës për të shkaktuar shkatërrim dhe për të mbjellë frikë.



Në raportin për të drejtat e njeriut në botë në vitin 2021, Departamenti i Shtetit tha se në Kosovë çështjet e rëndësishme të këtyre të drejtave përfshinin raporte të besueshme për: kufizime serioze në lirinë e shprehjes dhe medias, duke përfshirë dhunën ose kërcënimet për dhunë ndaj gazetarëve; korrupsionin serioz qeveritar dhe mosndëshkimin dhe krimet që përfshijnë dhunën ose kërcënimet me dhunë ndaj pakicave etnike ose komuniteteve tjera të marginalizuara.

Qeveria, thuhet në raport, ndërmori hapa për të identifikuar, hetuar, ndjekur penalisht dhe ndëshkuar zyrtarët që kryen shkelje të të drejtave të njeriut, por nganjëherë nuk kishte qendrueshmëri në veprimet.

Krimet e luftës

Në raport përmendet puna e Gjykatës së Posaçme të Kosovës për krime lufte, me seli në Hagë, dhe veprimet për ndjekjen e rasteve të krimeve të luftës nga gjykatat në Kosovë.

Deri në shtator, Prokuroria e Posaçme e Kosovës (PSRK) kishte nën hetim zyrtar 12 raste të krimeve të luftës. Gjatë vitit PSRK-ja ka nxjerrë një aktvendim për fillimin e hetimeve. Një rast i profilit të lartë të krimeve të luftës, i njohur si "Drenica I", u dërgua për rigjykim në vitin 2017, por u vonua disa herë. Deri në dhjetor nuk ishte mbajtur asnjë seancë dëgjimore.

Raporti vë re se në korrik, një gjykatë në Prishtinë dënoi ish-policin serb, Zoran Vukotić me tre vjet e gjysmë heqje lirie për përdhunimin e një gruaje shqiptare shtatzënë gjatë kohës së luftës dhe për pjesëmarrje



DASH, për Kosovën

në dëbimet e civilëve shqiptarë të Kosovës nga qyteti i Vushtrrisë, në vitin 1999. Që nga viti 2019, Vukotić ishte në vuajtje të dënimit prej gjashtë vitesh e gjysmë për krimet e luftës të ndalimit dhe torturimit të paligjshëm të të burgosurve shqiptarë nga Kosova në rajonin e Mitrovicës. Dënimi shtesë shënoi herën e parë që një gjykatë e Kosovës dënon një të pandehur për përdhunim gjatë luftës.

"Kosovë: Dhjetë vjet heqje lirie për përdhunim gjatë luftës"

Raporti përfshin edhe dënimin, në muajin mars, të serbit nga Kosova Zlatan Krstić dhe shqiptarit Destan Shabani, të dy ish-oficerë të policisë serbe, me përkatësisht 14 vjet e gjysmë dhe shtatë vjet burgim, për krime lufte kundër civilëve shqiptarë në vitin 1999. Ndërsa në shkurt, një gjykatë në Prishtinë dënoi serbin e Kosovës, Zoran Gjokić me 12 vjet heqje lirie për krime lufte kundër shqiptarëve të Kosovës të kryera ndërmjet marsit dhe prillit 1999 në rajonin e Pejës. Komisioni qeveritar për Persona të Zhdukur tha në muajin shtator se 1 mijë e 632 veta ende llogariten si të zhdukur gjatë luftës së viteve 1998-99 dhe dhunës politike që pasoi. Sipas ligjit, baza e të dhënave të

personave të zhdukur të qeverisë nuk përfshin përkatësinë etnike të personave të zhdukur, përveç nëse raportohet vullnetarisht nga familja e tyre. Komisioni la të kuptohet se rreth 70 për qind janë shqiptarë ndërsa 30 për qind ishin serbë, romë, ashkali, egjiptianë, boshnjakë, goranë, malazezë dhe të tjerë.

Keqtrajtimi i të burgosurve

Raporti përfshin edhe ankesat për keqtrajtimin e të burgosurve dhe përdorimin e dhunës nga pjesëtarët e organeve të rendit. Qeveria ndonjëherë hetonte shkeljet, megjithëse mekanizmat për ta bërë këtë nuk ishin gjithmonë efektivë ose ishin subjekt i ndërhyrjeve politike, gjatë periudhës që përfshin raportin. Forcat e sigurisë, thuhet më tej, nuk siguruan respektimin e urdhrave të gjykatës kur zyrtarët lokalë nuk i zbatuan ato. Edhe pse disa oficerë policie u arrestuan me akuza për korrupsion gjatë vitit, mosndëshkimi mbeti një problem.

Raporti përfshin të dhënat e Inspektoratit Policor të Kosovës, i cili deri në nëntor kishte pranuar 1 862 ankesa, 617 prej të cilave janë dërguar për hetim penal. Ankesat ishin kryesisht për keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare, keqpërdorim të detyrës zyrtare, lëndim trupor, kanosje dhe dhunë në familje. Inspektorati raportoi se 158

policë ishin nën hetim, 78 ishin pezulluar dhe 31 ishin arrestuar.

Pavarësia gjyqësore

Mes tjerash, raporti thekson se autoritetet ndonjëherë nuk arritën të zbatonin urdhrat e gjykatës, përfshirë edhe të Gjykatës Kushtetuese. Disa përfaqësues të serbëve të Kosovës pohuan se institucionet qeveritare dështuan në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në favor të serbëve të Kosovës, veçanërisht në mosmarrëveshjet lidhur me pronën. Autoritetet qendrore dhe lokale në Deçan vazhduan të refuzojnë zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese të vitit 2016 që konfirmon pronësinë e Kishës Ortodokse Serbe mbi më shumë se 24 hektarë tokë në afërsi të Manastirit të Deçanit. Në shtator, Gjykata Kushtetuese vuri në dukje refuzimin e vazhdueshëm të qeverisë për të zbatuar vendimin e gjykatës dhe ia referoi çështjen prokurorit të shtetit.

Deri në dhjetor, prokurori nuk kishte filluar procedimin penal. Asnjë nga zyrtarët që nuk kanë zbatuar urdhrin e gjykatës nuk janë sanksionuar, thuhet në raport.

Liria e shprehjes

Raporti thekson se ndonëse qeveria në përgjithësi e respektoi të drejtën e shprehjes, raportet e besueshme thonë se disa zyrtarë publikë, politikanë, biznese dhe grupe fetare u përpoqën të frikësonin përfaqësuesit e medias. Problemet e financimit gjithashtu dëmtojnë pavarësinë e medias. Gazetarët hasën në vështirësi në marrjen e informacionit nga qeveria dhe institucionet publike, pavarësisht nga ligjet që ofrojnë qasje në dokumente publike.

Mediat e pavarura, thuhet më tej, ishin aktive dhe shprehën një shumëllojshmëri pikëpamjesh, përgjithësisht pa kufizime. Megjithatë, pati raportime se zyrtarë qeveritarë, disa parti politike, biznese të lidhura me qeverinë, grupe fetare dhe individë të pakënaqur u bënë trysni pronarëve të mediave, redaktorëve dhe gazetarëve që të mos publikonin rrëfime ose materiale të caktuara. Disa gazetarë u përmbajtën nga raportimi kritik investigativ për shkak të frikës për sigurinë e tyre fizike ose vendin e punës. Deri në

dhjetor, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës raportoi 26 raste kur zyrtarët qeveritarë, njerëz të biznesit apo përfaqësues të grupeve të komunitetit ose grupeve fetare, shkelën lirinë e shtypit duke sulmuar fizikisht ose kërcënuar verbalisht gazetarët.

"Kosovë: Sulmohet gazetari Visar Duriqi"

Raporti vë re se disa gazetarët u ankuan se pronarët dhe menaxherët e medias i penguan ata të botonin ose transmetonin materiale kritike ndaj qeverisë, partive politike ose zyrtarëve të veçantë.

Përdhunimet dhe Dhuna në familje

Raporti citon Misionin e Bashkimit Europian për Sundimin e Ligjit, sipas të cilit gjykatat shpesh zbatonin dënime më të lehta se minimumi ligjor në rastet e përdhunimit dhe se organet e sundimit të ligjit rrallë ndërmerrenin hapa për të mbrojtur

viktimat dhe dëshmitarët. Zyra e Prokurorisë për Ndhimë ndaj Viktimave, raportoi një rritje të dhunës familjare nga 1 mijë e 145 raste të raportuara në vitin in 2020 në 1 mijë e 374 raste nga janarit deri në gusht të vitit 2021. Dhuna seksuale dhe përdhunimi që ndodhin brenda ose jashtë familjes, rrallë u raportuan nga viktimat, shpesh për shkak të frikës nga stigma shoqërore ose mungesa e besimit tek autoritetet.

"Protestë dhe reagime pas vrasjes së një 18-vjeçareje në qytetin e Ferizajt" Raporti iu referohet organizatave për të drejtat e grave, sipas të cilave ngacmimi seksual ishte i zakonshëm në vendet e punës si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat, duke përfshirë edhe institucionet publike të arsimit të lartë.

Presidentja Osmani: Lirinë e kemi fituar, por paqja për shumë qytetarë tanë nuk do të jetë e plotë derisa drejtësia për krimet e bëra të jetë përfundimtare"

14 prilli - Dita e të Mbijetuarve të Dhunës Seksuale gjatë luftës së fundit në Kosovë, mbledhi përfaqësues të lartë të shtetit Kosovë, mes tyre e pranishme ishte edhe presidentja znj. Vjosa Osmani, e cila ishte dhe nismëtarja për të përcaktuar këtë ditë si simbol të dhimbjes dhe forcës së femrës kosovare në përballje me agresorin serb.

"Shënimi i 14 prillit, muajit kur ka pasur më së shumti dhunime gjatë luftës së fundit në Kosovë, do të ishte vulosje e përhershme e një kapitulli tragjik të historisë sonë, dhe do të ishte bashkim i zërave tanë, për të treguar se si gra e burra të Kosovës, përkundër vuajtjeve të mëdha, e shndërruan vuajtjen e tyre në forcë, për të ngritur zërin për drejtësi", -tha Osmani.

Më tej presidentja foli edhe për situatën në Ukrainë, ku po raportohen përdhunime të grave nga ushtarët rusë.

"23 vite pas luftës në Kosovë, kur ne shpresonim se Europa e bota nuk do zgjohej më me imazhe e me dhimbje në sy të vajzave dhe grave, por jo vetëm, dhimbja dhe trishtimi zuri vend sërish në kontinentin tonë. Sot disa prej jush, por edhe shumë gra të tjera në Kosovë, bashkëndejnë e kuptojnë më së miri dhimbjen, trishtimin e zhgënjimin që janë duke përjetuar vajzat dhe gratë në Ukrainë, por edhe në vende të tjera të botës", -u shpreh e para e shtetit. "Ju vajza, gra, dhe burra, jeni shndërruar në rrëfyesin më të vërtetë e më të sigurtë, të vuajtjeve dhe përjetimeve të popullit tonë, e njëkohësisht jeni shndërruar në motivin tonë të përditshëm, në rrugëtimin tonë të përbashkët drejt drejtësisë. Drejtësia do të jetë e qëndrueshme vetëm atëherë kur kriminelët që kryen këto krime të dalin para drejtësisë. Lirinë e kemi fituar, por paqja për shumë qytetarë e qytetare tona nuk do të jetë e plotë derisa drejtësia dhe ndëshkimi për krimet e bëra të jetë përfundimtare".

Lidhja e Kombeve dhe Shqipëria në rrugëtimin shekullor të saj

Lidhja e Kombeve, si një organizatë ndërkombëtare erdhi fill pas Konferencës së Paqes të Parisit në vitet 1919-1920. Qëllimi i kësaj Lidhjeje ishte çarmatimi dhe parandalimi i luftërave bazuar në një siguri të përbashkët. Grindjet midis vendeve të ndryshme do të zgjidheshin nëpërmjet bisedimeve, mjeteve diplomatike dhe përmirësimit të mirëqenies globale. Filozofia e Lidhjes ishte e ndryshme me atë çfarë njerëzimi kishte bërë ndër shekuj. Ajo nuk do të kishte ushtri, prandaj mbetej të mbështetë tek forca e armëve e Fuqive të Mëdha, në mënyrë që të detyronte zbatimin e rezolutave të saj, të impononte sanksione ekonomike në raste të caktuara ose të mobilizonte forca ushtarake po ta kërkonin interesat e përgjithshme.

Çështje të tjera si kjo dhe traktate në lidhje me këtë duke përfshirë kushtet e punës, trajtimin e drejtë të banorëve vendas, trafikimi njerëzor dhe i drogës, tregtia e armëve, shëndeti global, robërit e luftës, dhe mbrojtja e pakicave në Europë. Në zgjerimin e saj më të madh nga 28 shtatori 1934 deri më 23 shkurt 1935, ajo kishte 58 shtete anëtare.

Lidhja e kombeve u krijua më 10 janar të vitit 1920. Plani prej 14 pikash, i Woodrow Wilson, propozuar në Konferencën e Paqes së Versajës, kërkonte formimin e një organizate ndërkombëtare që të mund të mbronte si kombet e mëdha ashtu edhe kombet e vegjël.

Ajo duhet të punonte në zgjidhjen paqësore të konflikteve botërore. Të mëdhenjtë e Konferencës së Paqes e aprovuan planin e tij. Qendra e Lidhjes u vendos në Gjenevë të Zvicrës,



pasi Zvicra ishte një vend neutral. Organet kryesore të Lidhjes ishin: Asambleja, ku bënin pjesë gjithë anëtarët e Lidhjes; Këshilli, i përbërë nga pesë anëtarët e përhershëm dhe katër anëtarët e radhës; Gjykata ndërkombëtare e Drejtësisë.

Gjermania dhe Rusia nuk u bënë anëtare të Lidhjes së Kombeve. SHBA-të propozuan krijimin e Lidhjes por nuk u bënë anëtarë të saj. SHBA-ja për këtë arsye, nuk mundi të luajë asnjë rol në mbështetje të veprimtarisë së Lidhjes. Dy anëtarët më të rëndësishëm ishin Britania dhe Franca, të cilët u përpoqën pa shumë sukses të mbështesin veprimtarinë e Lidhjes. Të dy kishin vuajtur shumë gjatë luftës dhe

nuk ishin entuziastë për t'u përfshirë në veprimtarinë e Lidhjes.

Krijimi i Lidhjes ishte i rëndësishëm. Ajo ishte një shpresë për forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe për të siguruar një paqe afatgjatë.

Gjuhët zyrtare të Lidhjes së Kombeve ishin Frëngjisht dhe Anglisht. Lidhja refuzoi adoptimin e Esperantos si gjuhë pune. Kina dhe Japonia e donin Esperanton, por Franca kundërshtoi fuqishëm. Në vitin 1939, një emblemë zyrtare për Lidhjen e Kombeve doli: dy yje me pesë cepa brenda një pesëkëndëshi blu. Ata simbolizuan pesë kontinentet e Tokës. Në një hark në krye shfaqet emri anglisht

"League of Nations", ndërsa në një tjetër në fund tregohet në Frëngjisht "Société des Nations",

Për të ardhur deri tek anëtarësia e vendit tonë në Lidhjen e Kombeve duhej të ishin patjetër në mbështetje Britania e Madhe dhe SHBA-të. Ndërsa Eduard Grey e kishte treguar interesin e tij për Shqipërinë në Konferencën e Ambasadorëve të vitit 1913, në Londër, do të duhej Presidenti Amerikan Wilson që të siguronte ekzistencën e shtetit tonë në Konferencën e Paqes në Paris, 1919. Në këtë akt, rol të rëndësishëm kanë luajtur Vatanët e Amerikës nëpërmjet delegatit të tyre në Konferencë, Reverend Charles Telford Erickson-i, pjesë e delegacionit shqiptar të kryesuar nga Turhan Pasha. Kjo jo vetëm do të ruante kufijtë e 1913-ës, por do të hapte rrugën për anëtarësimin e Shqipërisë në Lidhje. Për pranimin e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve kanë ndikuar dy elementë shumë të fuqishëm:

- Presidenti Wilson, i cili e mbrojti Shqipërinë në Paris, duke e shpëtuar nga copëtimi që i kishte rezervuar Traktati i Fshehtë i Londrës i vitit 1915;

- Lobimi i fuqishëm i anglezit Aubrey Herbert, me delegacionin britanik të përbërë ose alternuar prej Lordit Robert Cecil, Lordi Balfour dhe historianit M. Fisher.

Kështu veprimi i parë e ndihmoi të dytin. Shqipëria paraqiti kërkesën për anëtarësi në dhjetor të vitit 1920. Raportin e nënkomis-ionit për paraqitjen e kërkesës së Shqipërisë, e mbajti Lordi Robert Cecil, përfaqësues i Mbretërisë së Bashkuar, mik i afërt i Aubrey Herbert-it. Ai në argumentet e veta rreth Shqipërisë tha se, ndonëse kufijtë e Shqipërisë ende nuk janë përcaktuar përfundimisht, fakti që vendi ekziston prej disa vitesh brenda këtyre kufijve, e vërteton ekzistencën e tij si shtet. Ndonjë rregullim i mëtejshëm mund t'i lihej së ardhmes. Lordi Cecil tha se Shqipëria duhej pranuar pasi:

"Ajo prej virtutit përbënte një komb me dëshirë të njëzëshme të banorëve të vet".

Ajo çfarë Lordi Robert Cecil kërkoi në Asamblenë e Lidhjes së Kombeve nuk gjeti përkrahje për shkak të lakmive të fqinjëve dhe shteteve që i mbështesnin

ata. Megjithatë, ai lëshoi një apel të fuqishëm për anëtarësimin e Shqipërisë, i cili pati një efekt të jashtëzakonshëm. Në fjalën e tij ai deklaroi:

"Njohja fillimisht e sjell shtetin e ri në familjen e kombeve e më pas, ai vazhdon të ekzistojë që mos të zhduket prej ndonjë pushtimi apo ndonjë marrëveshjeje të përgjithshme të atyre që e lakmojnë atë; Qeveritë herë pas here ose i arrijnë qëllimet, ose dështojnë t'i arrijnë, por kur ekziston shteti si shtet, ai mbetet."

Falë kësaj këmbënguljeje të Lordit Robert Cecil në Komisionin e Pestë të Asamblesë u deklarua si më poshtë:

"Në tërësi ne jemi të mendimit se megjithëse Qeveria e Shqipërisë nuk është tërësisht në pozitën që i takon, prapëseprapë ajo është një qeveri e cila ka një shkallë të caktuar autoriteti në të gjitha pjesët e vendit dhe padyshim përfaqëson një ndjenjë shumë të fortë kombëtare, e cila shpërfill dallimet fetare.

Duket gjithashtu se vendi është i banuar prej një race të pastër shqiptare që flet një gjuhë të përbashkët, atë shqipe."

Argumentet e Lordit Cecil, si dhe puna e delegacionit shqiptar dhe veçanërisht paraqitja e çështjes shqiptare nga Fan Noli, bënë që Shqipëria të pranohej në Lidhjen e Kombeve më datën 17 dhjetor 1920. Ai në mënyrë të veçantë theksoi faktin se:

"Kufijtë e Shqipërisë ishin po

ata të caktuar nga Konferenca e Ambasadorëve dhe ajo konferencë nuk ishte abroguar. Ai theksoi faktin se shqiptarët ishin në zotërim të tërë territoreve, përveç një zone në Korçën e liruar nga francezët dhe pushtuar nga grekët.

Në ndihmë të Shqipërisë nga delegacioni britanik doli edhe Mr. H. A. L. Fisher, i cili mbështeti fort ruajtjen e integritetit të Shqipërisë dhe gjeti argumente shumë të forta ligjore ndërkombëtare, se përse Lidhja e Kombeve dhe Konferenca e Ambasadorëve, si dy trupa ndërkombëtarë nuk duhet të ndërthureshin në veprimtarinë e tyre në çështjet e kufijve të Shqipërisë, siç kërkonin fqinjët lakmitarë të vendit tonë. Ai deklaroi tekstualisht:

"Këshilli i Lidhjes së Kombeve e vlerëson si të pakëshillueshëm që

të merret njëherësh me të njëjtën çështje".

Ai shtoi se marrëveshja midis shteteve anëtare e përjashtonte ipso facto marrjen me çështjen e kufijve të Shqipërisë nga ana e Lidhjes së Kombeve.

Më 4 korrik 1921, Kryeministri shqiptar Vroni, paraqiti në Asamblenë e Lidhjes një apel ku i kërkonte Lidhjes të mos njihë asnjë shmangie nga kufijtë e caktuar prej Konferencës së Ambasadorëve të vitit 1913. Më datën 2 shtator 1921, u miratua një raport i përgatitur prej Lordit Balfour, ish-Sekretar i Jashtëm i Britanisë dhe një ndër arkitektët e Lidhjes së Kombeve.

Ai i doli zot Shqipërisë, duke e përmbledhur në tri fraza të përgjithshme tërë thelbin e kësaj çështjeje. Andaj ai udhëzoi:

- Asamblesë t'i kërkohej nga Shqipëria që të vepronte për përcaktimin e kufijve, ndërsa Këshilli të ndalonte dhunimin e tyre;

- Çështja e statusit të Shqipërisë të zgjidhej përfundimisht me pranimin e saj në Lidhjen e Kombeve;

- Trajtimi i pakicave rridhte jo nga Traktati i Paqes, por nga Rezoluta e Asamblesë së Lidhjes.

Këto ide të Lordit Balfour u pranuan dhe kjo pati një ndikim shumë të madh në mbarëvajtjen e punëve të më pastajme të Shqipërisë.

Më 4 tetor, në komisionin e gjashtë të Lidhjes, u paraqit një rezolutë prej Lordit të Afrikës së Jugut, Robert Cecil për kufijtë, e cila pas shumë debatesh, pas kuintave, kaloi e plotë duke i bërë një shërbim tjetër të madh çështjes shqiptare. Një kombinim i britanikëve Balfour – Fisher – Cecil nën ndikimin e kolonelit Aubrey Herbert, në Lidhjen e Kombeve, zgjidhi shumë probleme që nxirrnin herë grekët, herë jugosllavët, e herë italianët në forma të ndryshme, sa për pretendime territoriale, ashtu edhe për trajtim të pakicave.

Kështu u ra dakord për dhënien e shtetësisë çdo banori të Shqipërisë që kishte mbi dy vjet që jetonte aty pa dallim feje apo etnie. Po kështu lejohej përdorimi i çfarëdolloj gjuhe, por shqipja do të ishte gjuha zyrtare. Gjuha amtare sigurohej të përdorej në gjykata dhe fëmijët e minoriteteve të mësonin gjuhën e nënës së tyre.

Ushtarakët holandezë në Shqipëri...

PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

Qeveria e Holandës informon përfaqësuesit e Fuqive të Mëdha se Koloneli De Veer dhe Majori

Tomson janë udhëzuar të nisen për në Shqipëri dhe të përgatisin një plan për krijimin e një xhandarmërie. Gazeta zyrtare e Qeverisë së Vlorës "Përlindja e Shqipërisë" lajmëron për të dy oficerët e lartë, që do të vinin në Shqipëri duke iu dhënë një gradë më e lartë nga Mbretëresha e Holandës. Pas bisedimeve me Qeverinë e Ismail Qemalit, Koloneli Tomson u mor me përgatitjen e dokumenteve për organi-zimin e Xhandarmërisë Shqiptare dhe me trajnimin ushtarak intensiv të nënrepartëve të sapokrijuara. Në fillim do të përgatiteshin një mijë vetë, ndërsa në tërësinë e saj, Xhandarmëria Shqiptare ishte parashikuar me pesë mijë vetë. Ndërsa Gjenerali De Veer bashkëpunoi më shumë me Komisionin Ndërkombëtar, si dhe drejtonte operacionet ushtarake në terren.

Xhandarmëria e krijuar dhe e komanduar nga oficerët holandezë, shfrytëzoi bazat e krijuara prej tij, I. Qemalit. Ajo i shërbente, në radhë të parë, qëllimit të caktuar, paqësimit të Jugut. Oficerët holandezë mbështeteshin më tepër te Komisioni i Kontrollit. Gjenerali De Veer dhe Koloneli Tomson, dhënë një shembull të admirueshëm vendos-mërie dhe energjie dhe pavarësisht mungesës pothuajse totale të ndihmës, si dhe materialit tejet defektoz që kanë në përdorim, bënë një fillim shumë të mirë. Oficerët holandezë që u emëruan në shërbim të Xhandarmërisë shqiptare ishin pesëmbëdhjetë dhe përbënin Misionin Ushtarak në Shqipëri. Ky ishte një



Misioni i parë paqeruajtës ushtarak në Europë

Mision Ushtarak Paqeruajtës dhe Organizator Ushtarak për shtetin e ri shqiptar, që mund të vlerësohet si misioni i parë paqeruajtës ushtarak në Europë. Grupi i oficerëve holandezë që erdhi në Vlorë u prit

nga togeri Gerard Mallinckrodt, i cili ishte ndihmës i Kolonelit Tomson, si dhe togeri Meleq Frashëri, si përfaqësues nga Komanda e Xhandarmërisë Shqiptare, kapiten Tole Arapi dhe Mihal Grameno.

Përgatitja e detashmenteve të Xhandarmërisë shqiptare

Koloneli Tomson e kishte ndarë vendin në pesë zona, të cilat ishin Kor-ça, Gjirokastra dhe Jugu i Shqipërisë, Elbasani, Durrësi dhe Shkodra e Veriu i Shqipërisë. Ndaj dhe oficerët holandezë udhëtuan me shpejtësi në drejtim të zonave, ku ishin caktuar, bashkë me trupat e sapokrijuara të nënrepartëve të Xhandarmërisë shqiptare.

Marrja e detyrës ushtarake ishte tepër e rëndësishme për ta, si oficerë të karrierës ushtarake. Në shtypin e kohës, si në Vlorë, në Shkodër e Korçë përshkruhen vepri- met dhe qëndrimet e tyre, sidomos për rastet kur janë përfshirë në luftime dhe beteja, si në Korçë dhe në zonën Tepelenë-Gjirokastrë. Nën drejtimin e oficerëve holandezë në Vlorë dhe në Durrës u përgatitën disa detashmente të Xhandarmërisë shqiptare. Gjenerali De Veer dhe Koloneli Tomson i kishin krijuar, por edhe i kishin trajnuar këto reparte. Ata kishin hartuar edhe planin operacional për lëvizjen e tyre për marrjen në dorëzim të territoreve, që duhej të lironin trupat ushtarake greke, si dhe bandat e krijuara dhe të furnizuara prej tyre. Ishte plani- fikuar që tetë kolona ushtarake të niseshin në fillimin e marsit 1914 në rrugëkalimet drejt Himarës, Te- pelenës, Frashërit dhe Voskopojës.

Njëra kolonë pasi kaloi grykën e Vjosës në drejtim të Tepelenës u bombardua nga ushtria greke afër Sinanajt, në lartësinë e Gribës. For- cat u kompaktësuar dhe marshuan drejt Gjirokastrës. Në këtë kolonë kishte 400 xhandarë dhe rreth 1.200 luftëtarë popullorë vullnetarë, bashkë me çetën e Çerçiz Topullit. Edhe kolona me detashmentin tjetër në drejtimin e Këlcyrës dhe Përmetit u pengua nga trupat ushtarake greke. Situata në drejtimin e Himarës, ku po lëviznin rreth 100 xhandarë, u prit me armë nga pasuesit e ushtarëve grekë në hyrje të Vranishtit.

Oficerët shqiptarë e rivendosën situatën dhe ngritën flamurin kuq e zi. Kolona e nisur për në Jug-Lindje, pati më shumë sukses, ajo kaloi Voskopojën dhe mori në dorëzim Korçën. Kolona mbajti rregull në qytet dhe shkatërroi edhe komplotin

e organizuar në fillim të prillit nga ushtarët grekë. Luftimet vazhdonin rreth Gjirokastrës, si dhe në drejti- min Këlcyrë-Përmet.

Situata e rëndë ushtarake dhe oficerët holandezë

Oficerët e parë holandezë u ndodhën në situata të rënda ushta- rake, por trupat shqiptare siguruan rrethet jugore të Gjirokastrës dhe Korçës. Në vend të rindërtimit, iu desh të hynin në luftë me grekët pothuajse menjëherë. Kjo situatë do të zgjaste deri në fund të mis- ionit. Ndërsa në librin "Shqipëria, e shkuara dhe e tashmja" të Kostë Çekrezit, shkruhet se shqiptarët e ngushtuan darën rreth Gjiro- kastrës... Ata pothuaj po e shtinin në dorë qytetin, kur, në çastin vendimtar, Gjenerali Papulias, i Ushtrisë Mbretërore Greke, hodhi këmbësorinë dhe artilerinë kundër shqiptarëve, që po avanconin, duke i detyruar këta të ndalojnë. Ndërsa në zonën tjetër, të Korçës, kolona arriti të mposhtë edhe një komplot të armatosur, si dhe morën në dorëzim Bilishtin, Ersekën dhe Les- kovikun. Princ Vidi, në kujtimet e tij shkruan se: "...grekët kishin orga- nizuar edhe në Durrës, nën drejti- min e peshkopit grek, një sistem të plotë dhe tejet efektiv spiunazhi... dhe dërguan një farë Dr. Voila, i cili krijoi lidhje të afërta edhe me Esatin dhe, siç mësova më vonë, i kishte sjellë atij shpesh herë të holla". Marrëveshja e grekëve me Esatin kishte filluar që atëherë kur pashai luftonte kundër Qeverisë së Ismail Qemalit. Atëherë i ishin bërë dhe pagesat e para Esatit prej emisarëve grekë. Princ Vidi nuk e vlerësoi situatën. Ai u mbyll në Pallatin Mbretëror, duke shpresuar se do ta ndihmonin Fuqitë e Mëdha, që kishin anijet luftarake në Gjirin e Durrësit. Por e vërteta ishte krejt ndryshe. Kur qyteti u sulmua, ko- mandantët e tyre u thirrën për të shtënë ca topa sa për të trembur kryengritësit, por ata kundërshtuan, duke thënë se kanë urdhra të rrepta për të vepruar vetëm për mbrojtjen e personit të Princit e të familjes së tij. Kjo tregoi qartazi se Fuqitë e Mëdha kishin vendosur për të mos qëlluar me asnjë top për

mbrojtjen e qeverisë që kishin marrë përsipër për të themeluar. Në këtë situatë politike dhe ushtarake, kur përzihej rebelimi fetar në Shqipërinë e Mesme me luftimet në Shqipërinë e Jugut, oficerët holandezë bënë të pamundurën për të shmangur shkatërrimin shtetëror. Trupat e xhandarmërisë së re shqiptare, të komanduara nga oficerët holandezë e vlerësuan si përparësi të madhe situatën në Jug. Problem i madh po bëhej rebelimi fetar dhe rrethimi i Durrësit. Princ Vidi kreu një ins- pektim të të gjitha forcave ushta- rake, në mbroj-tje të Durrësit, ku shoqërohej nga Koloneli Tomson, i cili ishte caktuar Drejtor i Forcave të Armatosura, si dhe Komandanti Legjendar Isa Boletini. Përveç vull- netarëve, qyteti mbrohej nga 100 malësorë të armatosur, të cilët me të marrë kumtin e krye-ngritjes, shpejtuan t'i vinë në ndihmë Princit të tyre.

Për mbrojtjen e Pallatit Mbretëror, kishin zbarkuar mari- narët italianë dhe austriakë. Në Durrës numri i përgjithshëm i shqiptarëve të armatosur kapte rreth 300 vetë, prej të cilëve 200 ishin xhandarë.

Nderimi për komandantin holandez Tomson

Në këtë kohë oficerët holandezë ishin të vetmit mbrojtës të Durrësit duke komanduar malësorët shqip- tarë, gjuhën e të cilëve as që e kuptonin. Komandanti holandez Tomson me shokë, përpiquej jashtëzakonisht për t'i organizuar malësorët. Ata ia dolën mbanë dhe i nisën deri te Ura e Dajlanit. Tomsoni, i hipur mbi kalë, shkoj përpara deri tek vija e parë, por u qëllua në krahë dhe ra në tokë. Historia e Tomsonit është botuar tek ne. Busti i tij është ven- dosur në krye të Rrugës "Tomson" në Durrës, si dhe u shpall "Qytetar Nderi" i qytetit në vitin 2000. Emrin e Tomsonit e mban Akademia Ushta- rake e Nënoficerëve në Tiranë. Me propozim të Ministrit të Mbrojtjes, Koloneli Tomson është dekoruar në vitin 2003, nga Presidenti i Shqipë- risë, me Urdhrin e "Shqiponjës të Artë". Ushtaraku Fluturak Gërmenji ka botuar librin "Misionit Holandez" në Shqipëri.

Në vijim të ciklit të shkrimeve "Kafshët luftëtare si dhe njerëzit", po sjellim historinë e ariut-ushtar, Wojteku që u rekrutua ushtar për frontin e luftës dhe u bë i famshëm për njerëzimin. Në betejat e Luftës së Dytë Botërore, njerëzimi vijonte të "ftonte" të bëheshin bashkë edhe kafshët në këtë ndërmarrje të "domosdoshme" të njerëzimit, si pjesëmarrës në artin e shkatërimit. Luftërat, njerëzit dhe kafshët janë shndërruar në binjakë historikë, sepse shoqëritë njerëzore janë bashkëshoqëruar shekujve të përgjakshëm edhe nga kafshët. Kafshët janë gjithashtu shërbëtore të njerëzimit në situatë paqësore, por dhe në situatë luftarake. Kafshët janë përfshirë në luftëra bashkë me njerëzit, veçanërisht në kohët parahistorike e deri në ditët tona. Elefantët, devetë, kuajt, qentë, arinj-të, delfinët...pëllumbat janë bërë padashur "luftëtarë", janë "rekrutuar", kanë luftuar bashkë me njerëzit, kanë qenë në front dhe në prapavijë. Në përballjet luftarake të përgjakshme nëpër shekuj kafshët e luftës janë vrarë, plagosur e ngordhur ndoshta më shumë se të zotët e tyre. Por kafshët që kanë mbijetuar luftërave janë vlerësuar si të zotët e tyre, janë nderuar, respektuar, dekoruar me urdhra e medalje lufte, kanë marrë grada ushtarake ndoshta më shumë se të zotët. Për ta janë bërë filma e vepra letrare, janë ngritur monumente, kanë hyrë në dokumentacionin historik si dhe janë përjetësuar në kujtesën e njerëzimit. Në rrugëtimin luftarak në të gjithë luftërat, përfshi dy luftërat botërore nuk munguan dhe kafshët besnike të njerëzimit ku përveç qenit dhe kalit, kafshë-egërsira si ariu, u rritën mes njerëzve dhe imitonin ata sikurse ishte ariu "Wojtek", që u kthye në një ushtar besnik dhe i famshëm që i shpëtoi betejave të përgjakshme dhe u kthye triumfator e fitimtar nga lufta. Ngjarja zë fill më 8 prillin e vitit 1942, kur një grup robëresh polakë, që po transportoheshin nga



ARIU WOJTEK, LUFTËTAR NË BETEJA DHE HERO LUFTE

Siberia përmes Iranit në Lindjen e Mesme drejt Palestinës dhe më tej Aleksandrisë së Egjiptit. Edhe pse kanë kaluar dekada që nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore, një luftë e sprovë nga më të vështirat të njerëzimit në shekullin e njëzetë, lexuesit mbeten të interesuar të dinë gjithçka për betejat e saj, heronjtë, të rënët, taktikat, strategjitë, planet, veprimtaritë, ngjarjet, por dhe për heronjtë e mbijetuar. Kjo luftë ishte e mbushur me gjithçka, me gjak, dhimbje e lot, me gëzime dhe shpresë, me viktima të rënda dhe plot të papritura, me operacione unike ushtarake, por që kishte në front edhe kafshë të buta dhe të egra lufte si dhe ushtarë të pazakontë, sikurse ishte ariu ushtar, Wojtek. Ai ishte ushtari më i pazakontë i Korpusit të dytë polak, që u rekrutua në Iran, dhe kaloi në Siri,

Palestinë, Egjipt e Itali. Në Aleksandri u regjistrua zyrtarisht ushtar në repartin e furnizimit të trupave të artilerisë dhe së bashku me vëllezërit e tij ushtarë që për dy vjet ishte "nën armë", që u rrit, kalit, u mësua në luftë deri sa preku shijen e fitores. Jeta dhe vepra e një ushtari special nuk ishte as mit dhe as legjendë por një e vërtetë lufte, një fakt që qarkulloi gjatë, midis forcave aleate. Ariu i famshëm Wojtek, u bë një lloj "djali regjimental" i Ushtrisë Polake, edhe pse arinjtë janë veçanërisht të rrezikshëm në adoleshencën e "kthesës", kur fillojnë të mashtrojnë, binden dhe mund të sulmojnë papritur. Por Wojteku kishte trajnerë të shkëlqyer që ariun e trajtuan si njeri dhe jo si ari. Wojtek kopjoi dhe imitoi ushtarët e tjerë, në të gjitha veprimet e njerëzve, edhe duke marshuar përkrah tyre në këmbët

e tij të pasme, sepse i pa ata ta bënë këtë. Ngjarja e parë që e bëri të njohur ishte kur ushtari Wojtek neutralizoi një spiun të rrezikshëm nazist gjerman arab, që u detyrua nga ariu të ngjitej në një palmë, duke u frikësuar nga sulmi i shpejtë i një ushtari trim siç ishte Wojteku. Ndërkohë që gjatë betejave të ashpra të aleatëve në Itali, Wojtek tregoi guxim, duke transportuar municion artilerie direkt në vijën e parë të frontit. Nën zjarrin e kryqëzuar të forcave gjermane, ai nuk u largua kurrë nga pozicioni i luftimit dhe në këtë mënyrë i ndihmoi shokët e tij të përmbushnin urdhrin luftarak. E pazakonta, në këtë histori, është se ndër mijëra luftëtarë fronti, në frontet e Luftës së Dytë Botërore, ushtari Wojtek ishte thjesht një ari, i gjetur në Iran dhe i marrë me pagesë nga ushtarët e ushtrisë polake të Korpusit II. Në betejën e Montekasinos në Itali, ai ndihmoi gjuajtësit polakë të shkarkonin kutitë e municioneve dhe madje solli predha gjatë betejës, të cilat përjetësuan emrin e tij. Fiziku i fuqishëm i Wojteku u shfrytëzua nga "shokët" e tij ushtarë në kohë lufte. Faktikisht gjithë ushtarët që u njohën, bënë shoqëri dhe luftuan me Wojtekun, nuk i harruan kurrë luftimet në fushatat luftarake, shokun e tyre që e gjetën dyvjeçar dhe për dy vjet nga disa kilogramë në fund të luftës u bë një ari luftëtar i vërtetë me peshë mbi dyqind kg. Historia si dëshmitare ka hedhur dritë dhe ka ndriçuar rrugët e kujtesës si për njerëzit ashtu edhe për kafshët që luftuan në betejat e historisë dhe një prej "ushtarëve" pa atdhe është padyshim ariu Wojtek.

"Rekrutimi" i ariut Wojtek si ushtar i betejave i barabartë me njerëzit

Në një stacion hekurudhor në provincën Hamadan të Iran, më 8.4.1942, ushtarët polakë takuan një djalë të ri iranian, i cili kishte gjetur një këlysh ariu, nëna e të cilit ishte qëlluar nga gjuetarët. Një nga refugjatët civilë të luftës, që ishte në mesin e tyre, tetëmbëdhjetë vjeçarja Irena/Inka Bokiewicz, stërmbesa e gjeneralit Bolesław Wieniawa Długoszewski, e kishte pëlqyer këtë këlysh ariu dhe iu

lut togerit Anatol Tarnowiecki të blinte ariun e vogël, si të ishte një kukull. Blerja ishte thjesht me disa konserva mishi dhe kanoçe me ushqim të konservuar dhe pak para që ushtarët polakë e joshën djaloreshin iranian të qytetit të Hamadanit. Karriera e pazakonshme ushtarake e Wojteku fillonte atje, në malet Alborz, në veri të Iranit në provincën e Hamadanit. Në Iran polakët u vendosën në një kamp refugjatësh të krijuar pranë Teheranit, kryesisht nën kujdesin e Irenës dhe në muajin gusht 1942, ariu iu dhurua Kompanisë së 2-të të Transportit, e cila më vonë u bë Kompania e XXII e Furnizimit të Artilerisë. Këlyshi i ariut, fillimisht

Në përballjet luftarake të përgjakshme nëpër shekuj kafshët e luftës janë vlarë, plagosur e ngordhur ndoshta më shumë se të zotët e tyre. Por kafshët që kanë mbijetuar luftërave janë vlerësuar si të zotët e tyre, janë nderuar, respektuar, dekoruar me urdhra e medalje lufte, kanë marrë grada ushtarake ndoshta më shumë se të zotët.

pa emër, ishte shumë i vogël dhe nuk mund të përtypte as ushqimin vetë, prandaj ushtarët filluan ta ushqenin atë me qumësht lope nga një thithë e improvizuar e bërë nga një shishe. Këlyshit të vogël i gjetën edhe një emër. E emërtuan në polonisht "Wojtek", që është pseudonimi, forma zvogëluese i "Wojciech" ose "Luftëtar i lumtur/buzëqeshur", një emërtim i vjetër, ende i zakonshëm në Poloni. Ariu i vogël filloi të rritej dita ditës dhe ishte i kudogjendur në kompaninë e furnizimit të artilerisë, duke u regjistruar zyrtarisht në përbërjen e saj, por dhe i adhuruari dhe atraksion për ushtarët dhe civilët, që e ushqenin, ndërsa në këmbim, ai forconte moralin e tyre. "Pritja miqësore për ushtarët që ktheheshin, shpeshherë tejet të lodhur, nga ana e Wojteku ishte për ne

një moment i rëndësishëm relaksues", -kujtonte veterani polak Wojciek Narebski, në një intervistë të vitit 2011. Ushtarët polakë kishin vuajtur shumë në kampet sovjetike të internimit, shumë larg familjeve dhe miqve në kushte tejet të vështira. Wojteku ishte kthyer në burimin e vetëm të gëzimit.

Kur Korpusi i Dytë u transferua nga Irani në Palestinë, më pas në Afrikën e Veriut dhe prej andej më vonë në Itali, edhe Wojtek bëri të gjithë udhëtimin me ushtarët polakë. Ai nuk e dinte se ishte bashkuar me aleatët fitimtarë të luftës. Wojtek ishte rritur ndjeshëm, dhe ishte pjesë e gëzimeve "njerëzore", i privilegjuar të ushqej me fruta, marmelatë, mjaltë, shurup, për sjellje të mirë e shpërblenin me birrë dhe e kishin mësuar të pinte dhe duhan. Bile duhanin e kërkonte duke u rënë në sup me putër ushtarëve që kishte shok. Duhanin e shoqëronte mëngjesve edhe me kafe ashtu sikurse ushtarët e tjerë të repartit. Ushtarët ishin bërë trajnerë unikë, sepse nën udhëheqjen e tyre, ariu mësoi të përshëndeste të moshuarit e tij dhe të bënte mundje me njerëzit pa u shkakuar atyre ndonjë dëm, duke e bërë ariun që "të njihte shakanë" dhe të dinte kufijtë e dhimbjes tek njerëzit. Ai "përleshej" si me shaka me ushtarët, që shkaktonin ilaritet dhe gëzim. Në kampet fushore luftarake të kompanisë ndërtohej gjithmonë një kabinë e veçantë, por ushtari ari, nuk e pëlqente vetminë dhe pothuajse gjithmonë e kalonte natën me ushtarët në tenda.

Nga Aleksandria e Egjiptit drejt betejave të reja në Itali përmes Mesdheut

Trupa ushtarake polake ishte duke u transportuar nga Egjipti përmes Mesdheut drejt Italisë. Ka qenë fillimi i vitit 1944. Por përpara se të imbarkoheshin në anije zallamahia dhe rrëmuja ushtarake ishte diçka e pashmangshme. Zyrtarët e portit në Aleksandri refuzuan që të lejojnë ariun e egër që të hipë në anije, duke theksuar se vetëm ushtarët lejoheshin të hipnin në anije. Por peripecia u mbyll shpejt me regjistrimin e Wojteku zyrtarisht si ushtar. Kompania e 22-të e Artilerisë po ndihmonte të hipte

në anije një "shokun" e tyre ushtar. Autoriteti portual më në fund i dha leje të shkonte bashkë me "shokët", edhe një ari luftëtar i regjistruar, që prej dy vjetësh, bënte atë që quhej "jetë kazërme". Ishte dhe mbeti miku i tyre i ri i ushtarëve polakë që vinin nga Irani, një këlysh që kishte hedhur shtat dhe ishte pjesë e formacionit luftarak, gjithmonë i pandashëm në formacionet luftarake. Prej dy vjetësh, kjo qenie specifike, tepër e dashur me ushtarët kishte jetuar bashkë me ta, kishte bërë jetë kazërme. Ishte mësuar të jetonte, të flinte, të hante, të lahej, të luftonte me ushtarët, me disiplinë dhe me rresht. Ishte e habitshme se si ariu Wojtek, ishte bërë në ushtarin më të disiplinuar të kazermës ushtarake. Ushtarët polakë në këtë pikë të largët të atdheut të tyre ishin bërë aleatë me francezë e britanikë në vitin 1941, të burgosurit u liruan dhe u drejtuan në jug për të formuar një ushtri tyre. Fakt është se disa përfunduan më në jug dhe bashkë me ta edhe ariu "Wojtek". Ai ishte bërë familje për ushtarët. Ariu ushtar u bë shok e kaluar shokëve në luftë. Ai u falte gëzim dhe lumturi edhe në ato çaste të përgjakshme lufte. Për ta hipur në anije që të shkonin drejt Italisë çuan listat në kapitaneri dhe e kishin regjistruar me emrin "ushtari Wojtek". Ky ushtar special nuk kishte të paguar, por paguhej me dyfishin e racionit të ushqimit, sepse pesha e tij shpejt e kapërceu të dyqind kg. Në situata jo të zakonshme kur cigaret nuk mund t'i pinte u mësua t'i hante, ndërkohë që i pëlqente kaf-eja, ëmbëlsirat dhe birra që i ofronin ushtarët. Wojtek u bë shpejt edhe gaztor i ushtarëve, luante futboll me "shokët" me kambale. Frutat sidomos portokallet i hidhte si granata, më shumë në distancë se çdo ushtar tjetër. Pëlqente të ishte shoqëruar i arkave me municion në makinat e transportit të municionit, që në një farë mënyre u bë "profesioni" i tij. Uji ishte dobësia e tij. Nuk priste të "hiqte rrobat" sikurse ushtarët e tjerë sepse në kohë të nxehtë futej në ujë si një notar i klasit të lartë. Në betejën e Montekasinos, Wojtek u bë një ndër transportuesit mjeshtëror si predha mbajtës si dhe dinte t'i përdorte me kujdes maksimal predhat e artilerisë. Veprimet e këtij luftëtari të spikatur në luftë bënë që

regjimenti i artilerisë të ndryshonte simbolikën e tij dhe ta shndërronte në një ari me një predhë në krah. Pas betejës në Itali, dhe në mbarim të luftës ariu luftëtar u gradua "komandant" dhe pas luftës edhe u dekorua, por beteja e Montekasinos është stacioni luftarak që meriton pak më shumë vëmendje.

"Ushtari Wojtek" - luftëtar i denjë i frontit dhe hero i betejës së Montekasinos

Nuk ishte një ushtar i thjeshtë, por një luftëtar llogoresh, një ari simpatik që u bë i famshëm në Luftën e Dytë Botërore. Fati i egër i luftës i çoi një pjesë të ushtarëve polakë në drejtim të paparashikueshëm. Ushtarët polakë që kur takuan ariun Wojtek në Iran, kishin me vete një copëz bekim dhe zemrat e ushtarëve ishin bërë njësh përjetësisht me këtë shok betejash nga më të veçantët e jetës së tyre. Ai ishte një ari i çuditshëm e simpatik, që imitonte gjithçka. Bëhej gati për rresht dhe për front sikurse gjithë ushtarët e tjerë, rreshtohesh në vendin e vet, përshëndeste ushtarakisht, merrte drejtqëndrim në këmbë si njerëzit, lahej me ushtarët, shkonte në mensë, luante, bënte mundje, argëtohej dhe argëtonte ushtarët. Duket si e pabesueshme por cigaret ia mësuan ushtarët dhe ia ndiznin po ata si të ishte një efendi i vërtetë. Që kur ishte "rekrutuar" ishte përshtatur plotësisht me të gjitha rregullat ushtarake. Wojtekun e pajisën me librezë ushtarake, me numër matrikullimi, numrin serial të ushtarit, si dhe krejt rankimin e plotë të një luftëtari në luftë. Në dokumentacionin arkivor rezultojnë edhe gjeneralitetet për "ushtarin Wojtek". Askush nuk mund ta nënvleftësonte një ushtar të regjistruar, që qëndronte gjithmonë mes dy ushtarëve të tjerë. Gjatësia e tij 182 cm, në fillim të vitit 1944 si dhe pesha prej 90 kg plotësonte kriteret e një luftëtari madhor kur ishte në Itali në betejën e Montekasinos. Kujtimet e ushtarëve polakë nuk e kanë lënë mister zbarkimin në tokën italiane të ushtarit Wojtek. Në mesin e shkurtit të vitit 1944, mareshali britanik, Bernard Montgomery, në portin e Napolit, për të ndihmuar në procedimin e një

njësie të ushtarëve polakë, e cila sapo kishte arritur me anije nga porti egjiptian i Aleksandrisë, për të mbështetur ushtarët britanikë në luftën kundër njësive gjermane dhe italiane. Kontrolli i listave të ekvipazhit dhe bisedat me ushtarët e sapo arritur për anglezët ndeshën në një befasi: vetëm një person, ushtari Wojtek ishte zhdukur pa gjurmë sepse kishte "braktisur intervistën", por dhe nuk i përgjigjej "apelit ushtarak". Wojteku nuk po paraqitej. Një kolonel iu përgjigj duke qeshur: "Ai kupton vetëm gjuhën polake dhe atë perse". Ishte pjesëtari më i popullarizuar i repartit, që u bindej vetëm bashkëluftëtarëve të tij. Ka qenë 17 maj 1944, kur forcat aleate pas katër 4 muajsh luftimesh të ashpra (17.1.1944 deri më 17.5.1944), depërtojnë në vijën mbrojtëse të linjës gjermane Gustav në Itali, ku morën Romën. Beteja e Montekasinos ishte një ndër betejat e ashpra dhe më të përgjakshme të Luftës së Dytë Botërore, beteja që kishte edhe një luftëtar të ndërkombëtarizuar, ushtarin-ari, Wojtekun. Ndërkohë që për Wojtekun beteja e Montekasinos ishte "Pagëzimi i zjarrit" sepse kur ushtarët shkarkonin kamionët me predha, Wojteku u shndërrua në krye ushtar, i disiplinuar dhe i zoti, që lëvizja e tij ishte plot produktivitet nga prapavija në frontin e luftës. Në shenjë mirënjohjeje, kompania e 22-të zgjodhi si emblemë të re siluetën e një ariu që mban një predhë në putrat e tij, që ruhet edhe sot e kësaj dite me këtë simbolikë gati tetëdhjetë vjeçare. Në këtë betejë, ndër më të përgjakshmet e luftës, aleatët perëndimorë, gjatë së cilës amerikanët dhe britanikët depërtuan përmes vijës mbrojtëse të linjës gjermane Gustav dhe morën Romën, patën humbje të konsiderueshme: SHBA dhe aleatët më shumë se 55 mijë njerëz; ndërsa nazistët gjermanë rreth 20 mijë ushtarë. Të katër betejat e Montekasinos drejtoheshin për aleatët perëndimorë nga gjeneral Harold Aleksandër, Mark Klark dhe Oliver Leese, ku në luftime ishin Armata e Pestë e SHBA-ve dhe Armata e Tetë Britanike, ndërsa gjermanët drejtoheshin nga mareshal Albert Kesselring, kolonel gjeneral Heinrich von Vietinghoff, që mbronin

vijën e përballjes me armatën e 10-të gjermane. Fakt është se gjatë Luftës së Dytë Botërore, ushtritë aleate pushtuan nga jugu dhe u përpoqën të shtyjnë drejt veriut dhe t'i detyrojnë gjermanët të largohen nga Italia. Montekasino besohet të ishte një strehë strategjike për trupat gjermane, dhe për këtë u bombardua në një betejë të zgjatur nga avionët aleatë, që shkatërruan plotësisht manastirin, që në fakt ishte një strehë për civilët. Beteja e Montekasinos ishte një pikë kthese në luftë, por me një kosto jashtëzakonisht të lartë, por dhe humbje tragjike ndaj trashëgimisë kulturore, përfshirë dorëshkrime të paçmuara. Edhe pse u rindërtua sipas planit origjinal u rihap nga Papa VI më 1964, dy dekada pas lufte. Abacia e Montekasinos ndodhet 130 km në jug të Romës dhe 100 km në veri të Napolit, në malin mbi qytetin e Kasinos në rajonin jugor të Lacios. Gjithë treva vendase dhe jo vetëm mësoi se për marrjen e Montekasinos luftonte edhe një ari. Në të dy anët e frontit ka hyrë në histori ushtari-ari Wojteku, që mbante lehtësisht arkat e municionit dhe i stivonte ato në makina si të ishte njeri.

Arkat e municionit që kërkonin katër ushtarë, Wojteku i mbante i vetëm, për këtë edhe u gradua "tetar", "rreshter", "kapter" dhe ngjiti shkallët më të larta në karrierë. Wojteku i vogël i dikurshëm në përfundim të luftës u rrit dhe u bë ari i madh, 1.82 cm i gjatë dhe peshonte mbi dyqind kilogramë. Ushtarët polakë e shfrytëzuan për fuqinë e tij si bartës i arkave të mbushura përplot me predha/mina të rënda të mortajave. Asnjë predhë/minë nuk i binte nga duart/putrat gjatë transportimit të municioneve, duke u kthyer kështu një luftëtar i denjë i frontit, rreshtuar me fitimtarët e luftës. Kur Wojteku mbante arka municioni "e ngritën në detyrë", i akorduan gradat ushtarake "si breshër" në supet e ushtarit Wojtek, ndërsa njësia e tij luftonte në fushatën e Italisë bashkë me aleatët anglezë dhe amerikanë. Nuk dihet nëse Wojtek arriti të marrë gradën gjeneral apo jo, me shumë mundësi jo, pasi nuk rezulton në asnjë regjistër që Wojtek të ketë qenë edhe "shef shtabi i përgjithshëm"

ndonjëherë!

Ariu Wojtek - një luftëtar heroik, më i graduari, më i dekoruari dhe më i njohuri i arinje pjesëmarrës në luftë në historinë e njerëzimit

Në vitin 1945, njësitë ushtarake fituese të LIIB, në pamundësi për ta kthyer ushtarin e jashtëzakonshëm në atdheun e tyre, u dërguan në Britaninë e Madhe, ku u shpërndanë në shtëpitë e tyre. Wojtek u transportua në Berwickshire, Skoci, me pjesën tjetër të kompanisë së 22-të të furnizimeve. Ata u stacionuan në aeroportin Winfield në Farm Sunwick, afër fshatit Hutton, Skocia Borders. Wojtek shpejt u bë i njohur në mesin e civilëve vendas dhe të shtypit, dhe Shoqata Polako-Skoceze e bëri ariun luftëtar një anëtar nderi të kësaj shoqate. Edhe pse Wojteku nuk kishte shtëpi, ushtarët u kujdesën për "shtëpinë e tij të re" më 15 nëntor 1947 në kopshtin zoologjik të Edinburgut në Skoci. Në Edinburg, Wojteku u bë një mjeshtër në punët e shtëpisë dhe preferencat e tij ndryshuan. U përshtat me kohën e paqes. Tashmë nuk do të jetonte më si në kushte lufte. Ai tani hante sikurse njerëzit gjalpë regël e mjalte. Merrte pjesë në gjitha aktivitetet veçanërisht për fëmijë, duke u bërë aktiv në veprimtaritë e fëmijëve. Wojteku e bëri të njohur edhe kopshtin zoologjik të Edinburgut, ku kaloi pjesën tjetër të jetës së tij, i vizituar shpesh nga gazetarë dhe ish-ushtarë polakë, disa prej të cilëve i hidhnin cigare për të ngrënë, siç bëri gjatë kohës së tij në ushtri. Vëmendja e medias kontribuoi në popullaritetin e madh të Wojtekut dhe për këtë Ai ishte një mysafir i shpeshtë në programin Blue Peter për fëmijë të televizionit BBC. Historia e Ushtarit Wojtek është bërë objekt filmash, librash, tregimesh si dhe ka shtatë statuja në Poloni dhe në Britani, ka një memorial në Britani dhe në Kanada. Shtëpia e tij e fundit ka qenë në kopshtin e Edinburgut në një kopsht zoologjik skocez. Këtu iu shtuan shokët dhe vizitorët. Ishte bërë i famshëm. Rreth vitit 1958 në Poloni, për një kohë të shkurtër filloi një fushatë e vërtetë për "kthimin" e Wojtek në "vendlindjen" e shokëve të tij ushtarë, edhe pse ariu nuk e vizitoi kurrë në fakt atdheun e miqve të tij polakë. Edhe pse kopshti zoologjik i Edinburgut deklaroi se ishte gati

të transferonte ushtarin Wojtek, autoritetet polake nuk e miratuan transferimin për shkaqe "politike", sepse ushtarët miq të ariut ishin kundërshtarë të vendosur të regjimit politik socialist të vendosur në Poloni, prandaj edhe përgjigjja ishte: "refuzim kategorik". Në Edinburg të Skocisë është përkujtuar Wojteku me një monument në një nga sheshet e qytetit, për ushtarin e pazakontë të Luftës së Dytë Botërore, për ushtarin trim Wojtek. Ish-shokët e tij polakë, por më tej edhe britanikë, dhe jo vetëm, nuk e lanë kurrë vetëm, ndërsa në dhjetor të vitit 1963 kur ishte 22 vjeç, që peshonte rreth pesëqind kg. Njoftimi për vdekjen e tij ishte i klasës së fisnikërisë njerëzore: "Me keqardhje ju njoftojmë se ka ndërruar jetë një ushtar i famshëm polak". Ushtarët polakë dhe jo vetëm kishin humbur një shok të betejave luftarake, një ari-ushtar, një ushtar të lumtur, që depërtoi në historinë e njerëzve dhe që askush nuk u shpreh "ngordhi", por "ndërroi jetë", sepse ishte një fitues në luftë, iu njohën meritat, iu dhanë gradat e ofiqet, u nderua e respektua si rrallë ndonjë luftëtar heroik. Wojteku i dha emër nënrepartit ushtarak ku shërbeu për arsye se u etiketua si "ushtari predha mbajtësi më i mirë për predhat e artilerisë" dhe për këtë arsye nënrepartit të tij dhe për nder të tij i bënë një emblemë të re, që simbolizonte një ari me një predhë në putrat e tij dhe kjo ishte "Emblema e Kompanisë së 22-të të Furnizimit të Artilerisë" të polakëve. Është fakt se Wojtek u shndërrua në simbol të solidaritetit mes Polonisë dhe Skocisë, që vijon të jetojë në kujtesën e popujve të të dy vendeve.

Trembëdhjetë vjet më parë, më 2009, Parlamenti i Skocisë organizoi një pritje në nderim të ushtarit Wojtek, sepse historia e tij është unike, ndërkohë që rrëfimet me tregime vijnë, edhe me libra dhe në film. Statuja e bronzit, në qendër të Edinburgut, e nëntorit 2015, e bën ariun Wojtek të vendosur në kujtesën e njerëzimit. Në vitin 2011, Will Hood, regjisori i filmit dokumentar, "Ariu Wojtek që shkoi në luftë", u pyet se çfarë e ka ngazëllyer në rrëfimin dokumentar për këtë ari-luftëtar. "Fakti se ai vetë ka menduar se është njeri, ngre disa pyetje interesante për atë se çfarë është të jesh njeri?!", -u përgjigj regjisori Will Hood.

REVISTA MBROJTJA

Organ Qendror i Ministrisë
së Mbrojtjes Viti i 90-të i botimit



5 MAJ

DITA E DËSHMOREVE TË KOMBIT SHQIPTAR

Adresa:

Rruga e Dibrës/ Garnizoni "Skënderbej"